

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 1 nga 41

Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (DTEEK)


	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 2 nga 41

Përmbajtja

Hyrje	4
Historiku	5
Supozimet lidhur me Tregun e Energjisë elektrike.....	7
Struktura e Dokumentit	9
PJESA I: ÇËSHTJET PARIMORE	10
1. Struktura e Tregut.....	10
2. Shkurtesat dhe Definicionet.....	11
3. Palët dhe Llogaritë e tyre	11
4. Aderimi në Rregullat e Tregut dhe Tërheqja	15
5. Komunikimet e të Dhënave të Tregut	16
6. Kërkesat e Tregut për Matje të energjisë	16
7. Transferimi i Konsumatorëve.....	17
8. Alokimi i Kapaciteteve Interkonektive dhe Tregtimi.....	18
9. Njoftimi për Kontrata të Energjisë.....	19
PJESA II: AKTIVITETET NJË DITË PARA DHE NË DITËN E	
TREGTIMIT	20
10. Një Ditë Para: Parashikimi i Ngarkesës	20
11. Nominimet Fizike dhe Kontraktuese Një Ditë Para	20
11.1 Tregu Një Ditë Para.....	20
11.2 Planifikimi një ditë para.....	20
12. Programi i balancuar dhe nominimet përfundimtare.....	21
13. Kontraktimi dhe Përcaktimi i Çmimeve për Shërbimet Ndihmëse	22
14. Mekanizmi Balancues: Një Ditë Para dhe në Kohë Reale	23
15. Aktivitetet një ditë para	24
16. Aktivitetet në ditën D	25
17. Kalkulimi i Jo-Balanceve të Energjisë	26
18. Kalkulimi i Çmimit të Jo-Balancit.....	28
19. Barazimi	29
20. Detyrimet.....	31
21. Faturat	32
22. Kontestet	33
PJESA III: QEVERISJA.....	34
23. Kërkesat për garancion financiar	34
24. Raportimi dhe Informatat e Tregut.....	34
25. Gjendjet Emergjente në Sistem.....	35

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 3 nga 41

26.	Procedura për Ndryshimin e Rregullave të Tregut.....	35
27.	Dispozitat e Përgjithshme	36
SHTOJCAT		37
	Shtojca A: tregu D-1 plani kohor (indikativ)	37
	Shtojca B: Definicionet.....	39
	Shtojca C: Shkurtesat.....	41


	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 4 nga 41

Hyrje

Me 21 korrik 2010, Qeveria e Kosovës ka miratuar një Koncept Dokument të përgatitur nga Grupi Punues për Dizajnin e Tregut nën udhëheqjen politike të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ky dokument përcakton parimet e një tregu të reviduar të energjisë elektrike për Kosovën - “Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës” ose DTEEK, që do të jetë në pajtueshmëri me Ligjin për Energjinë Elektrike. DTEEK ka për qëllim të mbështesë ristrukturimin e mëtejshëm të sektorit të energjisë dhe në të njëjtën kohë të avancojë objektivin e Qeverisë për arritjen e një furnizimi më të besueshëm, më ekonomik dhe më të qëndrueshëm me energji elektrike në Kosovë. Dizajni do të krijojë kushte për themelimin e një tregu konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike.

Pas vendimit të Qeverisë dhe nën patronazhin e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është themeluar Komiteti Drejtues, i cili kishte për detyrë zbatimin e parimeve të Konceptit në një dizajn të hollësishëm të tregut dhe rekomandimet e nevojshme për revidimin e legjislacionit sekondar, Kodeve dhe Rregullave ekzistuese në mënyrë që ato të jenë në pajtim me objektivat e Qeverisë. Në përcaktimin e Termave të Referencës së Grupit Drejtues, Qeveria i ka kushtuar rëndësi roleve përkatëse të ZRRrE dhe KOSTT të përcaktuara me ligj: ZRRrE është përgjegjëse për miratimin e Dizajnit të Tregut, Rregullave të Tregut dhe Kodeve të reviduara, ndërsa KOSTT është përgjegjës për të siguruar që dizajni i tregut do të jetë në gjendje që në aspektin funksional të përmbushë objektivat e Qeverisë për sektorin e energjisë elektrike dhe në të njëjtën kohë i mundëson KOSTT, si OST, mekanizmat e nevojshëm për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë që ka sipas licencës së tij dhe Ligjit. Ministria e Energjisë dhe Minierave ka formuar një Grup Punues Teknik – të kryesuar nga KOSTT, operator i pavarur i sistemit, transmisionit dhe tregut të Kosovës – për të adresuar këto dhe çështjet e ndërlidhura në më shumë hollësi. Në veçanti KOSTT do të specifikojë rolet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrëseve në treg, do të përcaktojë rrjedhat e energjisë, rrjedhat financiare, rrjedhat e informatave ndërmjet pjesëmarrësve dhe do t’i paraqes Grupit Drejtues një dizajn të përshtatshëm dhe të dakorduar të tregut. Ministria e Energjisë dhe Minierave më tej ka kërkuar nga KOSTT që të hartojë dhe t’i prezantojë Grupit Punues Teknik propozimet e tyre për një dizajn të tregut i cili do të përmbushë kërkesat e një sistemi të qëndrueshëm dhe të besueshëm dhe që do të reflektojë zotimin e Qeverisë për realizimin e projekteve për kapacitetet e reja gjeneruese dhe projekteve tjera për privatizim.

Ky dokument paraqet propozimet e KOSTT për dizajnin e përgjithshëm të DTEEK. Dizajni i tregut është i hartuar që të jetë në pajtueshmëri me ligjet e miratuara (ne fuqi prej 1 dhjetor 2010) për Energji, Rregullatorin e Energjisë dhe për Energjinë Elektrike, në pajtim edhe me praktikën e mira të industrisë. Figura 1 (më poshtë) ofron një ilustrim të përgjithësuar të strukturës së sistemit elektroenergetik të Kosovës.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 5 nga 41

Struktura e Tregut





Figura 1. Rrjedhat Fizike ne Sistemin e Kosovës

Historiku

Komisioni Evropian, si pjesë e projektit të tij për themelimin e një tregu të vetëm të përbashkët të energjisë elektrike, ka ndërmarrë një iniciativë që të mbështesë vendet e regjionit të Evropës Juglindore (EJL) në harmonizimin e politikave të tyre nacionale të energjisë dhe zhvillimin e një kornize të përbashkët rregullative me qëllim kryesor që të:

- Tërheq dhe ndihmojë investimet në sektorin e energjisë elektrike;
- Përmirësojë sigurinë e furnizimit; dhe
- Përkrahë rritjen ekonomike.

Me 25 tetor 2005 Kosova ka nënshkruar Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe me këtë është bërë partner i barabartë në zhvillimin e Komunitetit të Energjisë, gjë që është

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 6 nga 41

e një rëndësie primare për zhvillimin ekonomik të Kosovës e që i mundëson asaj të eksploatojë rezervat e mëdha të linjitet dhe pozitën e saj të favorshme për shkëmbim të energjisë në regjionin e EJJL.


Si pjesë e këtij procesi, Kosova paraprakisht ka miratuar legjislacionin primar për energjinë i cili përcakton të drejtat dhe obligimet e palëve në sektorin e energjisë elektrike për të siguruar furnizim të qëndrueshëm, të sigurtë, të besueshëm dhe kualitativ me energji elektrike. Ligji për Energjinë Elektrike përcakton rregullat e përbashkëta për gjenerim, transmision, shpërndarje, furnizim, import/eksport dhe transit të energjisë elektrike, për qasje në rrjet, për tregun e energjisë elektrike dhe përcakton përgjegjësitë dhe të drejtat e pjesëmarrëseve në treg.

Ministria përgjegjëse për energjetikë, në pajtim me Ligjin për Energjinë ka zhvilluar Strategjinë e Energjisë të Kosovës, e cila është strukturë e kombinuar e qëllimeve dhe principeve fundamentale me një plan fleksibil të implementimit duke marrë parasysh zhvillimet dhe planet kohore të nevojshme për të përmbushur objektivat e saja. Strategjia krijon kushte të mira për pjesëmarrjen e investitorëve privat në industrinë e energjisë elektrike në Kosovë.

Duke ditur nevojën për investime në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë dhe pamjaftueshmërinë e burimeve ekzistuese për të plotësuar nevojat e furnizimit, Qeveria ka iniciuar një ristrukturim të mëtejshëm të industrisë së energjisë elektrike me qëllim të liberalizimit dhe rritjes së konkurrencës në tregun e energjisë elektrike.

Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen aktuale të vështirë të sektorit të energjisë elektrike në Kosovë, nuk mund të pritët që menjëherë të mbështesë hapjen e plotë të tregut konkurrues. Mungesa historike e investimeve në rrjet; varësia nga importet me çmime dhe besueshmëri të pasigurt; mungesa e kapaciteteve gjeneruese për të përmbushur kërkesën në rritje; niveli i lartë i papranueshëm i humbjeve jo-teknike; dhe mbi të gjitha, pozita e dobët financiare e pjesëmarrësve kryesorë në treg, tregojnë nevojën e zhvillimit të një tregu të përkohshëm (kalimtar) – i cili megjithatë do të jetë atraktiv për investitorët privat në prodhimin e energjisë, shpërndarje dhe furnizim, i cili do të rrisë transparencën dhe do të përcaktojë çmimin e tregut dhe i cili ka qëllim të zhvillohet drejt objektivave afatgjata të Qeverisë.

Duke marrë parasysh hierarkinë e dokumenteve legale, Dizajni i propozuar duhet të jetë në përputhje me Ligjet dhe Strategjinë e Energjisë. Rrjedhimisht, dizajni duhet të akomodojë marrëveshjet e propozuara komerciale për të tërhequr investimet e jashtme të nevojshme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë. Dizajni paraqet një vizion më afat gjatë të strukturës së tregut. Rregullat e Tregut që do të kenë për bazë këtë dokument do të jenë kalimtare për nga natyra dhe do të përfshijnë realitetet afat shkurtra teknike dhe komerciale në sektor.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 7 nga 41

Supozimet lidhur me Tregun e Energjisë elektrike

Dizajni i Tregut të energjisë elektrike do të paraqet një treg bilateral në të cilin pjesëmarrësit e licencuar blejnë dhe shesin energji për të mundësuar një sistem energjetik të balancuar. Tregu është i shoqëruar me një mekanizëm balancues në të cilin OST i licencuar pranon oferta për blerje dhe shitje të energjisë për të menaxhuar diferencat e rrjedhave të cilat nuk janë të mbuluara me kontrata bilaterale.

Dizajni i tregut do të akomodojë një shumëllojshmëri të kontratave bilaterale. Më poshtë janë përmbledhur supozimet e bëra lidhur me këto marrëdhënie në mënyrë që të amandamentohen Rregullat e Tregut:


KEK-u si gjenerator i licencuar do të vazhdojë të ketë në pronësi njësitë e TC Kosova A (dhe njësitë e Kosova B deri në privatizim), dhe do të ketë tarifa të rregulluara të miratuara nga ZRRrE. Sipas këtyre kontratave KEK do të shes kapacitet dhe energjinë FP sipas një kontrate bilaterale në pajtim me Nenin 7 dhe 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

FP do të furnizojë të gjithë Konsumatorët e Pa-Kualifikuar dhe gjithashtu mund të furnizojë edhe Konsumatorët e Kualifikuar. Kur furnizon Konsumatorët e Kualifikuar kjo mund të bëhet me tarifë të rregulluar dhe tarifë jo të rregulluar.

Investitorët për Kosovën e Re do të kenë kontrata bilaterale ndërmjet kompanisë së tyre të projektit që do të jetë gjenerator i licencuar, dhe FP në pajtim me Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Këto kontrata bilaterale priten të marrin formën e marrëveshjeve për blerjen e energjisë (MBE). Sipas MBE, FP do të blejë kapacitetin e vënë në dispozicion dhe energjinë e dispeçuar nga Kosova B dhe njësitë të TCKR.

Ndërmarrja në pronësi shtetërore, gjithashtu një gjenerator i licencuar, e cila ka në pronësi hidrocentralin Ujmani (Ibër Lepenc) do të ketë kontrata bilaterale të rregulluara me FP për kapacitetin dhe energjinë e prodhuar nga centrali i Ujmanit në pajtim me Nenin 7 dhe 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Në një të ardhme, burimet e reja të ripërtërishme (p.sh. njësitë me erë dhe njësitë e vogla hidrike etj) do të programohen të operojnë në bazë të parimit “duhet të punojë sa herë të jetë e mundur” dhe energjia e tyre i shitet FP sipas kushteve të përshkruara në “Rregullat për Mbështetjen e Energjisë elektrike për të cilën është lëshuar një Certifikatë e Origjinës dhe Procedurat për Pranimin në Skemën Mbështetëse” të nxjerrë nga ZRRrE.

Importuesit dhe Eksportuesit mund të importojnë ose eksportojnë energji nëpërmjet interkoneksioneve me vendet fqinje varësisht nga disponueshmëria e kapacitetit interkonektiv. Brenda Kosovës, ata do të lidhin kontrata bilaterale me Gjeneratorët dhe Furnizuesit në mënyrë që të blejnë dhe shesin këtë energji. Nuk pritet që çmimet e kontratave bilaterale të miratohen nga rregullatori pasi që ato do të jenë të bazuara në tregtimet me shumicë të realizuara në tregjet jashtë Kosovës. Ka gjasa që këto tregtime do të përmbajnë një çmim të vetëm për kapacitetin dhe energjinë.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 8 nga 41

Kur prodhimi vendor nuk është i mjaftueshëm, FP ka të drejtë që vet të bëjë importimin e energjisë elektrike. KEK do të ketë edhe rolin specifik të Importuesit të përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike në mënyrë që të realizojë importe shtesë kur prodhimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar obligimet e shërbimit publik të FP në pajtim me Nenin 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike ndërsa nuk ka ndonjë obligim specifik ligjor për asnjë palë për eksporte kur prodhimi vendor kalon kërkesën vendore.

Konsumatorët e Kualifikuar (aktualisht konsumatorët jo-shtëpiak dhe nga 2015 të gjithë konsumatorët) do të kenë mundësinë që të ushtrojnë të drejtat e Konsumatorëve të Kualifikuar sipas DTEEK. Konsumatorët e Kualifikuar mundë të transferohen te Furnizues i ri.


Furnizuesit që do të aderojnë, do të jenë të lirë të lidhin kontrata bilaterale me Gjenerator ose Furnizues tjerë në Kosovë, të importojnë ose eksportojnë energji sipas kontratave bilaterale me Importuesit dhe Eksportuesit në mënyrë që të furnizojnë KK me të cilët kanë lidhur kontratë bilaterale.

Konsumatorët mund të shfrytëzojnë njehsorët interval (matje për çdo orë) dhe jo interval. Duke pasur parasysh investimet e vazhdueshme në teknologjinë për matje në Kosovë, pritet që pikat matëse të kyçura në nivelin e tensionit 10kV e më lartë do të shfrytëzojnë njehsorë interval, edhe pse nuk ekziston një kërkesë e tillë. Rregullat e Tregut nuk do të kenë nevojë që në ditën 1 të implementimit të tyre të përballen me Konsumatorë të Kualifikuar që janë transferuar dhe shfrytëzojnë njehsorë jo-interval. Në fazat e hershme të tregut, sipas të gjitha gjasave do të transferohen konsumatorët që tashmë kanë njehsorë interval.

Pasi disa nga obligimet sipas Ligjit janë të lidhura me kërkesën për energji (ngarkesën) të Konsumatorëve të Kualifikuar, është e preferuar të bëhet regjistrimi i transferimit të tyre te një Furnizues tjetër. Para 2015 kjo do të formojë një bazë të një kontrolli të vlefshmërisë së një aplikacioni për transferim.

FP mund të merr përsipër obligimet për pagesë të kapacitetit sipas marrëveshjes për blerje të energjisë ose marrëveshjeve tjera të ngjashme. Neni 18.12 i Ligjit për Energjinë Elektrike thekson, *“Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të sigurojë që aftësia e furnizuesit publik për përmbushjen e detyrimeve të pagesës ndaj një prodhuesi sipas një marrëveshjeje për blerjen e energjisë elektrike të mos zvogëlohet në rast se konsumatorët e kualifikuar vendosin të furnizohen nga furnizuesit e tjerë aktiv në tregun konkurrues. Për këtë qëllim Zyra e Rregullatorit të Energjisë mund të krijojë mekanizma, siç është mekanizmi për lëshimin e energjisë elektrike i përcaktuar në nenin 25 të Ligjit për Energji Elektrike”.*

Dizajni i Tregut është krahasuar me modele të tjera të mundshme për plotësimin e kërkesave të parashtruara në Artikullin 25 të Ligjit, duke përfshirë programin lehtësues i cili mundëson inkorporimin e këtyre mekanizmave edhe pse vendimi përfundimtar për mekanizma të ngjashëm mbetet përgjegjësi e ZRrE.


	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 9 nga 41

Struktura e Dokumentit

Struktura e dokumentit është përgatitur në bazë të strukturës së Rregullave ekzistuese të Tregut të cilat janë të njohura për pjesëmarrësit aktual në treg dhe të miratuara nga ZRrE.

- **Pjesa I** përshkruan strukturën bazë të tregut dhe kërkesat për menaxhimin e rrjedhave të energjisë në rrjetin elektrik të Kosovës dhe pasojat financiare të shkaktuara nga këto rrjedha.
- **Pjesa II** përcakton kërkesat specifike për operimin e sistemit; kalkulimin e pasojave financiare të operimit ditor dhe marrëdhëniet e sistemit të Kosovës me sistemet regionale fqinje; dhe
- **Pjesa III** përshkruan çështjet e qeverisjes në lidhje me tregun.
- **Shtojca A** përcakton planin kohor indikativ me renditjen e ngjarjeve të parashikuara në fazën një ditë para;
- **Shtojca B** definon termet të cilat nuk janë të definuara në dokumentacionin ekzistues si Ligji për Energjinë Elektrike, dhe Rregullat e Tregut ekzistuese ose Kodin e Rrjetit.
- **Shtojca C** ofron listën e shkurtesave të përdorura.

Shtojca B dhe C janë të ofruara që të ndihmojnë në diskutimin e Dizajnit të Tregut. Në këtë fazë ato nuk janë të menduara, të ofrojnë definicione obliguese ligjore.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 10 nga 41

PJESA I: Çështjet parimore

1. Struktura e Tregut

DTEEK në parim definohet nga kontratat e lidhura ndërmjet Furnizuesve dhe Gjeneratorëve. Këto kontrata në dizajnin e tregut janë përshtatur ashtu që formojnë një Treg Bilateral, duke deklaruar një ditë para disponueshmërinë e kapaciteteve dhe nominimet e energjisë së kërkuar nën ato kontrata. Për të siguruar parakushte për një ambient të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të mëtejme në sektorin e energjisë elektrike, të gjitha palët e licencuara dhe palët e tjera të cilat vullnetarisht aderojnë në Rregullat e Tregut, duhet që individualisht të njihen si pjesëmarrës në këtë treg. Si i tillë, secili pjesëmarrës, si rregull bazë, do të formojë grupin e vet balancues. Kjo nuk përjashton mundësinë e krijimit të një Pale Përgjegjëse për Balancim (PPB) për një grup të furnizuesve ose grup të gjeneratorëve, por fillimisht Rregullat e Tregut nuk do të mundësojnë këtë; ndryshimet pasuese të rregullave për të mundësuar regjistrimin e PPB mund të inkorporohen pa ndonjë ndryshim fundamental të dizajnit nëse kjo është dëshirë e pjesëmarrësve në treg.

Tregu Bilateral është i shoqëruar me një Mekanizëm Balancues (MB) i dizajnuar që të ndihmojë Operatorin e Sistemit të Transmisionit (OST) që të mbajë sistemin të balancuar një ditë para po ashtu dhe në kohë reale. Ky është një mekanizëm bilateral i cili me kohë mund të zgjerohet ose zëvendësohet varësisht nga zhvillimet në Tregun Balancues të parashikuar me propozimin e Bankës Botërore për Hapjen e Tregut me Shumicë (HPSH) për tregun regional.


Operatori i Tregut (OT) do të menaxhojë parashikimin e kërkesës për energji D-1 të pjesëmarrësve të tregut, nominimin dhe miratimin komercial, programin orë për orë (skedulimin), barazimin pas ditës së tregtimit të energjisë së programuar dhe të furnizuar nën MB si dhe devijimin e paqëllimshëm të pjesëmarrësve nga sasitë e energjisë së nominuar në fazën një ditë para. Palëve ju lëshohen faturat për jo-balancet dhe detyrimet për DRr/DOS/ DOT/ etj. OT gjithashtu do të menaxhojë aderimin e Palëve në treg, regjistrimin e sistemeve matëse dhe transferin e Konsumatorëve të Kualifikuar ndërmjet Furnizuesve.

Në mënyrë që të krijohen kushte më të mira në dizajnimin e kontratës, kapaciteti dhe energjia e nominuar nën kontrata bilaterale do të barazohet financiarisht ndërmjet Palëve jashtë tregut.

Për qëllime operative çfarëdo instruksioni nga qendra dispeçerike e OST duhet të dërgohet drejtpërdrejtë në elektrokomandën e gjeneratorit të licencuar.

Objektivat e Dizajnit të Tregut

Objektivat kryesorë të dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike me shumicë janë nxjerrë nga Ligji për Energjinë Elektrike (2010) dhe Licenca e OT. Çfarëdo konflikti ndërmjet objektivave të Tregut të përshkruara në Rregullat e Tregut dhe Licencën e OT do të interpretohet në favor të Licencës.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 11 nga 41

Objektivat kryesore të dizajnit të Tregut janë:

- (i) Të zhvillojë DTEEK i cili do të krijojë parakushtet për një treg konkurrues të energjisë elektrike dhe të ndihmojë investimet në Prodhimin e energjisë elektrike, tregtim më efikas ndërkufitar me qëllim të krijimit të një tregu të përbashkët të energjisë elektrike në tërë BE.
- (ii) Të ofrojë kushte për prodhim, transmision, shpërndarje dhe furnizim të sigurtë e të besueshëm të energjisë elektrike, duke zbatuar parimet e efijencës.

Rregullat e Tregut

Zhvillimi i dizajnit të tregut me shumicë dhe përpilimi i rregullave për implementimin e këtij dizajni është përgjegjësi e OT. Obligimet dhe të drejtat janë të përcaktuara në Nenin 24 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Rregullat përcaktojnë qartë mënyrën se si palët mund të tregtojnë në këtë treg. Në të njëjtën kohë dhe në mënyrë që të lehtësohet tregtimi, rregullat mbulojnë një sërë ndërveprimesh të cilat nuk janë të mbuluara me Kodet tjera.

Që një treg të operojë dhe Palët Tregtare të tregtojnë energji elektrike nga to kërkohet që të aderojnë në Rregullat e Tregut. Megjithatë, kjo nuk është e realizueshme pa një ambient ku mund të menaxhohen rrjedhat fizike të energjisë në rrjetin elektrik - që është roli i OST. Rregullat e Tregut përcaktojnë rregullat se si palët mund të tregtojnë me njëra tjetrën. Gjithashtu, ato përcaktojnë se si këto palë do të bashkëpunojnë dhe komunikojnë me OST në mënyrë që të mirëmbahet balanci fizik i sistemit.

Kushtet primare nën të cilat OST do të operojë sistemin janë përcaktuar në Kodin e Rrjetit dhe ekzistojnë ndërlidhje të konsiderueshme ndërmjet Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit. Rregullat e Tregut duhet gjithmonë të jenë në pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit.


2. Shkurtesat dhe Definicionet

Në këtë seksion, të gjitha shkurtesat, definicionet dhe shpjegimet e përdorura në Rregullat e Tregut, në veçanti për përdorimin e shprehjeve algjebrike, janë përcaktuar për referencë.

Ky seksion do të zhvillohet gjatë përpilimit të Rregullave të Tregut. Megjithatë, Shtojca B e këtij dokumenti ofron shpjegime për disa terma shtesë të përdorura për të shpjeguar DTEEK të cilat nuk janë në përdorim në Rregullat ekzistuese të Tregut, Kodin e Rrjetit ose Ligjin për Energjinë Elektrike. Shtojca C gjithashtu ofron një listë të shkurtesave të përdorura në këtë dokument.

3. Palët dhe Llogaritë e tyre

Ky seksion përcakton marrëdhëniet në mes Palëve, dhe rolet e tyre primare në Treg. Të gjitha Palët do të kenë licencë të lëshuar nga ZRrE, në përputhje me rolin e tyre në Treg. Palët mund të

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 12 nga 41

adherojnë në Rregullat e Tregut në më shumë se një cilësi/rol. Figura 2 paraqet një ilustrim të përgjithshëm të marrëdhënieve kontraktuese ndërmjet Palëve të ndryshme në Treg.

OT do të mirëmbajë një regjistër të kontratave bilaterale të Palëve në Treg, për të regjistruar Palët homologe, kapacitetin në disponim dhe të dhënat për energjinë, por jo edhe detajet financiare të kontratave. OST/OT do të duhet të kenë qasje në vëllimet e energjisë në disponim sipas kontratave bilaterale në mënyrë që të miratojë programin e tyre për angazhim të energjisë e cila do të paraqitet si nominim një ditë para. OT gjithashtu do të mbajë një regjistër të llogarive të Palëve. OT i përdorë këto llogari për të kryer procesin e Barazimit dhe është përgjegjëse të mbaj llogaritë korresponduese.





Figura 2: Marrëdhëniet Kontraktuese ndërmjet Pjesëmarrësve të Tregut

Palët, dhe rolet e tyre përkatëse në Treg janë:


- Operatori i Tregut (OT), aderon në Rregullat e Tregut në cilësinë e “pronarit” dhe është përgjegjës për menaxhimin e procedurave për ndryshimin e rregullave (modifikimet). OT është përgjegjës për menaxhimin ekonomik të sistemit elektrtoenergetik dhe për

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 13 nga 41

administrimin e tregut të energjisë elektrike. Detyrat e tij kryesore janë: regjistrimi i të gjitha kontratave bilaterale në mes palëve, barazimi i pagesave të tregtimit në mes palëve, regjistrimi i sistemeve matëse të nevojshme për barazim, regjistrimi i palëve që mbajnë të drejtat për kapacitetin interkonektiv si dhe publikimi i informatave relevante për tregun. OT do të mirëmbajë llogaritë e agreguara për barazimin e energjisë dhe atë financiar të Palës si pasojë e Mekanizmit Balancues, do të lëshojë faturat mujore dhe inkasojë paratë që Palët Tregtare i detyrohen OST (dhe anasjelltas), por vet nuk do të përfshihet në tregtim të energjisë për përfitim ose nuk do të ketë në pronësi kapacitete gjeneruese. OT gjithashtu në baza ditore pranon ofertat për blerje (zbritjen e prodhimit nga Gjeneratorët dhe rritjen e ngarkesës nga ana e Furnizuesit) dhe oferta për shitje (rritjen e prodhimit nga ana e Gjeneratorëve apo zbritjen e ngarkesës nga ana e Furnizuesit), etj.


- Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) aderon në Rregullat e Tregut në cilësinë/rolin e operatorit të sistemit dhe ofruesit të shërbimeve. Detyrat kryesore të tij janë operimi i sistemit të transmisionit (ST), balancimi fizik i sistemit sipas kushteve të Kodit të Rrjetit dhe për nevoja të tregut, dorëzimin e leximeve të njehsorëve për qëllime të Barazimit. OST është përgjegjëse për blerje të shërbimeve ndihmëse dhe në emër të Pjesëmarrësve në Treg për blerje të energjisë balancuese. Ai përdor OT si agjent të vet për barazimin financiar të këtyre kontratave si dhe për kalkulimin dhe mbledhjen e detyrimeve nga palët për shërbimet e shfrytëzimit të rrjetit dhe operimit të sistemit. OST do të ketë llogarinë(të) e vet për të mbuluar koston e humbjeve në rrjetin transmetues dhe devijimet e paqëllimshme të shkaktuara si devijim nga programi i shkëmbimit me OST fqinje, si është përshtetur në Doracakun Operativ të ENTSO-E. Në pajtim me Nenin 13 të Ligjit për Energji Elektrike, përveç nëse kërkohet për zbatimin e këtyre funksioneve, OST nuk do të tregtojë energji për përfitim dhe nuk do të ketë në pronësi kapacitete gjeneruese.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes¹ (OSSH) aderon në rregulla në cilësinë/rolin e operatorit të rrjetit dhe ofruesit të shërbimeve. Roli i tij kryesor është që të operojë sistemin e Shpërndarjes (SSh) në pajtim me Kodin e Shpërndarjes. Shërbimet që i kryen për nevoja të tregut janë: ofrimi i faktorëve të humbjeve të Shpërndarjes (FHH) për Gjeneratorët dhe Konsumatorët e Kualifikuar të kyçur në rrjetin e Shpërndarjes dhe dorëzimin e leximeve të njehsorëve për qëllime të Barazimit Përfundimtar. Humbjet në Shpërndarje do të llogariten me metodologjinë e OSSH për caktimin e tarifave. OSSH nuk do të tregtojë energji ose nuk do të ketë në pronësi kapacitete gjeneruese.

¹ Parashihet një OSSH, por mundet të ketë më shumë se një, gjë që do të kërkonte vetëm ndryshime të vogla të Rregullave të Tregut.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 14 nga 41

- Gjeneratorët aderojnë në Rregulla të Tregut në cilësinë e Palëve Tregtare. Ata do të njoftojnë kontratat bilaterale të energjisë tek OT dhe kanë një Llogari Gjeneruese për regjistrimin e Pozitave (vlerave) të Nominuara dhe të udhëzuara të njërive të tyre dhe vëllimeve të matura të energjisë për nevoja të barazimit financiar. Aktivitetet e tyre kryesore në treg janë:
 - Të operojnë në pajtim me kodet teknike relevante (Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes, Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes të Shpërndarjes);
 - Të nominojnë tek OST/OT, një ditë para, programin e prodhimit orë për orë dhe palët kontraktuese, sipas kontratave të tyre bilaterale me Furnizuesit dhe Eksportuesit;
 - Të dorëzojnë ofertat për shitje/blerje të energjisë në Mekanizmin Balancues;
 - Të bashkëpunojnë me OST dhe të ndihmojnë në balancimin e sistemit në kohë reale; dhe
 - Të shesin energji, kapacitet dhe shërbimet ndihmëse Pjesëmarrësve tjerë në Treg.

Është thelbësore që në pajtim me praktikat e mira industriale, duhet të ketë komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet qendrës dispeçerike të OST dhe elektokomandave të Gjeneratorëve.
- Furnizuesit aderojnë në Rregullat e Tregut në cilësinë e Palëve Tregtare. Ata do të njoftojnë për kontratat e tyre bilaterale të energjisë tek OT dhe do të kenë një Llogari të Energjisë së Furnizimit për regjistrimin e vëllimit të energjisë së Nominuar dhe të matur, për nevoja të barazimit financiar. Funkzionet kryesore të një Furnizuesi në treg janë:
 - Të operojë në pajtim me kodet relevante teknike (Kodi i Rrjetit, Kodi i Shpërndarjes, Kodi i Matjes dhe , Kodi i Matjes së Shpërndarjes);
 - Të parashikojë kërkesën për energji një ditë para orë për orë (në rast të FP ndaras për konsumatorët e vet për Obligimin e tyre për Shërbim Publik dhe furnizimin për Konsumatorët e Kualifikuar), të rritur me faktorin e humbjeve në shpërndarje sipas një metodologjie të publikuar;
 - Një ditë para të nominojë tek OST/OT, palët kontraktuese homologe dhe sasinë e kontraktuar orë për orë të energjisë që do të furnizojë për të mbuluar kërkesën për energji sipas kontratave bilaterale me Gjeneratorët dhe Importuesit;
 - Të dorëzojë oferta për blerje të energjisë dhe oferta për shitje të energjisë në Mekanizmin Balancues; dhe
 - Të blejë dhe të shes energji dhe kapacitet në tregun nacional dhe regjional
- Importuesit/Eksportuesit (Furnizuesit me Shumicë) dhe tregtarët ndër-kufitar aderojnë në Rregulla të Tregut në cilësinë/rolin e Palëve Tregtare. Ata do të kenë një Llogari të

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 15 nga 41

Kapacitetit Interkonektiv për regjistrimin e të Drejtave për Kapacitetin Interkonektiv të alokuar për ta në secilin interval kohor, dhe Llogaritë për të regjistruar rrjedhat e nominuara të importit dhe eksportit. Funkzioni i tyre kryesor në treg është që të nominojnë një ditë para sasinë e energjisë orë për orë e cila do të tregtohet në secilin drejtim dhe në secilin kufi interkonektiv dhe palën kontraktuese homologe për këto tregtime.

4. Aderimi në Rregullat e Tregut dhe Tërheqja


Ky seksion përcakton kërkesat për Palët që duan të aderojnë në Rregullat e Tregut në mënyrë që të marrin pjesë në DTEEK. Ky seksion gjithashtu përcakton kërkesat për ata që duan të ndërprejnë (tërhiqen) pjesëmarrjen. Aderimi i parë i Pjesëmarrësve në Rregullat e Tregut si palë origjinale ka ndodhur me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut, në rolet e Gjeneratorit, Furnizuesit Publik, Tregtarit, OST, OT dhe OSSH. Palët e reja do të aderojnë në Rregullat e Tregut me nënshkrimin e Marrëveshjes për Aderim, si definohet në Rregullat e Tregut.

Aderimi në Rregullat e Tregut është obligativ për:

- Furnizuesin Publik (FP);
- Furnizuesit e Konsumatorëve të Kualifikuar, të kyçur në ST ose SSh;
- Importuesit/ Eksportuesit (Furnizuesit me Shumicë në Kosovë);
- Tregtarët Ndër-Kufitar; dhe
- Gjeneratorët (duke përfshirë Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) me:
 - Njësitë Gjeneruese të kyçura në ST; ose
 - Njësitë Gjeneruese të kyçura në SSh (Gjeneratorët distributiv) me kapacitet nominal të instaluar më të madh se pesë (5) MW; ose
 - Stabilimente për prodhimin e energjisë elektrike të kyçura në ST ose SSh me kapacitet nominal të instaluar më të madh se dhjetë (10) MW.

Procedura për aderim mbulon çështjet si:

- Formën e aplikimit dhe taksa;
- Dëshmitë dokumentuese që duhet të dorëzohen nga pala aplikuese si definohet në Rregullat e Tregut, duke përfshirë edhe dëshmitë për mbulimet e sigurisë/garancionet financiare të cilat OT arsyeshëm mund ti kërkojë (detajet shtesë për aranzhmanet e garancionit financiar do të përcaktohen në Seksionin 23);
- Rolin e Operatorit të Tregut në:

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 16 nga 41

- Verifikimin e kompletimit të informatave të palës aplikuese
- Verifikimin e garancioneve financiare të palës aplikuese;
- Njoftimin e Palëve ekzistuese në Treg dhe ZRRë për aplikimin e Palës;
- Përgatitjen e një Marrëveshje për Aderim për ekzekutim nga Pala, dhe pas përfundimit të suksesshëm, nënshkrimin e saj në emër të të gjithë nënshkruesve të RrT;
- Procedurën nëse Aderimi refuzohet –ankesa eventuale te ZRRë (shih Zgjidhjen e Kontesteve);
- Obligimet e Palës për Aderim – të regjistrojë kontratat e veta, llogaritë e energjisë dhe parasë së gatshme, sistemeve të matjes, etj.

Rregullat e Tregut do të përcaktojnë procedurat dhe planin kohor për tërheqjen e Palëve nga tregu (tërheqja), qoftë vullnetarisht ose jo (me arsye për këtë të fundit), dhe obligimet pasuese për OT dhe Palën tërheqëse. Planet kohore për tërheqje vullnetare do të bëhen në një afat kohor të caktuar, për të siguruar përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare të pa faturuara. Që të mbrojnë pjesëmarrësit tjerë në treg, tërheqja e pavullnetshme e një pale mund të pritët të jetë më e shpejtë. Gjasat për mos pagesën e faturave në rrethanat e tilla paraqet nevojën për Garancion Financiar si është përcaktuar në Seksionin 23.

5. Komunikimet e të Dhënave të Tregut


Sistemet e komunikimit për qëllime të tregut (kryesisht për Njoftime dhe Barazime) nuk kërkojnë nivelin e njëjtë të shpejtësisë së komunikimit sikurse komunikimi për të dhëna operative (të cilat Palët gjithashtu mund të jenë të obliguara t'i ofrojnë, sipas Kodit relevant). Kërkesat minimale për komunikim të besueshëm dhe sigurt ndërmjet Palëve Tregtare dhe OST/OT janë përcaktuar në këtë seksion.

Komunikimi në mes Palëve bëhet me telefon, faks dhe përmes internetit (në një faqe të sigurt të mbrojtur me fjalëkalim).

OT do të ketë obligim që të publikojë të gjitha informatat e nevojshme për Tregun (varësisht nga kofidencialiteti i informatave) dhe të mirëmbajë një arkiv të këtyre informatave për 5 vite, me qasje për të gjithë pjesëmarrësit në Treg dhe palët tjera të interesuara.

6. Kërkesat e Tregut për Matje të energjisë

Operimi eficient i DTEEK varet nga disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave matëse për rrjedhat e energjisë në sistem dhe nga sistemi. Kjo kërkon që pajisjet e matjeve të jenë me një

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 17 nga 41

saktësi dhe besueshmëri të caktuar, për të ofruar të dhënat e nevojshme për barazimet në Treg (për detyrimet e shfrytëzimit të Rrjetit Transmetues (TUoS) dhe të detyrimeve tjera).

Ekzistojnë grupet matëse në të gjithë kufijtë e Sistemit të Transmisionit. Këto matje mundësojnë llogaritjen e saktë të prodhimit, konsumit, rrjedhave në interkoneksion dhe humbjeve në transmision për nevoja të barazimit.

Standardet teknike, dizajni dhe standardet operative për sistemet e tilla të matjeve përcaktohen në Kodin e Matjes (KM) dhe Kodin e Matjes të Shpërndarjes (KMSH).

Rregullat e Tregut përcaktojnë obligimet e të gjitha Palëve Tregtare që të ofrojnë informatat për sistemet matëse për qëllim të mirëmbajtës së një ose më shumë regjistrave të Pikave Matëse për OST dhe OSSH të cilët kanë për detyrë që me kohë ti dorëzojnë të dhënat e leximit të njehsorëve të Pala Tregtare dhe tek OT në formatin e specifikuar elektronik.

Nëse të dhënat e matura mungojnë ose kanë gabime, OST/OSSH duhet të bëjnë vlerësimet e tyre më të mira të vlerës së ‘saktë’.

Duhet të cekët se Pala Tregtare është përgjegjëse për ofrimin e të dhënave të sakta për Barazim tek OST/OSSH si agjentë të tyre.

7. Transferimi i Konsumatorëve


Ky seksion përshkruan procedurat dhe planin kohor me të cilin një Konsumator i Kualifikuar (KK) mundet të ndërrojë Furnizuesin. Rregullat duhet të jenë në pajtim me rregulloret për ndryshimin e furnizuesit të zhvilluara sipas Ligjit për Energjinë Elektrike.

Neni 19 i Ligjit për Energji Elektrike përcakton se të gjithë konsumatorët përveç konsumatorëve shtëpiak tashmë janë Konsumator të Kualifikuar. Që nga 2015 të gjithë konsumatorët do të jenë Konsumator të Kualifikuar.

Rregullat e Tregut kryesisht do të mbulojnë ato kërkesa të nevojshme për të siguruar barazimin e saktë të tregut si: instalimi i sistemeve matëse të përshtatshme me qëllim që energjia e matur t’u ngarkohet furnizuesve në llogaritë e tyre përkatëse të energjisë.

Kur të lidhet një kontratë për furnizim me pakicë ndërmjet një furnizuesi dhe një konsumatori, nga Pjesëmarrësit në Treg pritet që të ndërmerren hapat vijues minimal:

- Furnizuesi i ri duhet të njoftojë OT për qëllimin e tij për të iniciuar transferimin e konsumatorit (ose zgjedhjen);
- OT do të njoftojë Furnizuesin aktual;
- OT do të miratojë aplikacionin (p.sh. kontrollojë me OST/OSSH që konsumatori ka të instaluar njehsorët e përshtatshëm, se të dhënat e sistemit të matjes ndërlidhen me konsumatorin në fjalë, se konsumatori ligjërisht ka të drejtë të jetë Konsumator i Kualifikuar), dhe

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 18 nga 41

- Nëse nuk ka kundërshtim nga Furnizuesi dhe aplikacioni është vlerësuar pozitivisht, OT do të kompletojë dhe regjistrojë transferin në sistemin e regjistrimit të Pikës Matëse dhe do të bëjë korrigjimet përkatëse në faturimin e secilit furnizues.

Rregullat e Tregut gjithashtu do të ofrojnë mundësinë për ankesë te ZRrE në rast të kontestimit ose refuzimit të një transferimi.

Miratimi i transferimit është proces i aranzhimeve të drejtuar nga OT që të sigurojë se transferimi i propozuar është në pajtim me kërkesat e përcaktuara në procedurat për transferimin e konsumatorit, të miratuara nga ZRrE si pjesë e Rregullave të Tregut. Aranzhimet detale do të përcaktohen në Procedurën e Tregut për Transferimin e Konsumatorit të referuar nga Rregullat e Tregut. Ato do të zhvillohen gjatë zhvillimit të konkurrencës me pakicë.

Për të minimizuar koston dhe kompleksitetin e shfaqur pas hyrjes në fuqi të aranzhimeve të propozuara, kërkesa për energji e FP do të mund të përcaktohet duke aplikuar metodologjinë e diferencës d.m.th. kërkesa për energji e FP do të kalkulohet si ndryshim ndërmjet kërkesës nacionale për energji dhe shumës së kërkesës për energji të Konsumatorëve të Kualifikuar të Transferuar. Që të kryhet ky proces, kërkesa për energji e Konsumatorit të Kualifikuar të Transferuar duhet të përcaktohet me saktësi.

Duhet të mirëmbahen një ose më shumë Regjistra të Pikave Matëse në mënyrë që të mbështet Barazimi. Mund të kombinohet operimi i disa nga këta regjistra me ata të Bazës së të Dhënave të Matjeve të përshkruara në Kodet e Matjes.


Për një njësor të konsumatorit, përveç regjistrimit të vetive teknike të njehsorit, kërkohet që regjistri të përmbajë emrin e furnizuesit i cili e furnizon me energji nëpërmjet atij njëtori, pavarësisht nëse konsumatori është Konsumator i Kualifikuar ose jo. Nëse është e nevojshme që të përcaktohet vëllimi i energjisë për furnizimin e Konsumatorëve të Kualifikuar nëpërmjet tarifave konkurruese, kundrejt tarifave të rregulluara për Konsumatorët e Kualifikuar të publikuara nga Furnizuesi Publik në pajtim me Nenin 18.6.2 të Ligjit për Energji, atëherë në regjistrin e njehsorëve duhet të shënohet një simbol për të treguar llojin e tarifës.

8. Alokimi i Kapaciteteve Interkonektive dhe Tregtimi

Ky seksion përshkruan aktivitetet me të cilat OT do të organizojë ankandin dhe do të bëjë alokimin e të Drejtave për Kapacitetin Interkonektiv (DKI) për importuesit dhe eksportuesit².

Importuesit dhe Eksportuesit potencial duhet të kenë parasysh se këto procedura mund të zëvendësohen me procedurat të cilat janë duke u zhvilluar nga një entitet/trup regjional i

² Procedura Operative, e publikuar në ueb faqen e KOSTT, do të ofroj më shumë detaje

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 19 nga 41

themeluar për implementimin e Rregullores 1228/2003/EC për mbikëqyrjen e tregtisë ndërkufitare në regjionin e SEE.

OT do të mirëmbajë një regjistër të palëve të cilat dëshirojnë të fitojnë dhe përdorin DKI dhe do të organizojë ankande periodike (vjetore/mujore/një ditë para/intra ditore) për Kapacitetin Transferues në Dispozicion (KTD) për të cilin mund të ofertojnë Importuesit dhe Eksportuesit e licencuar. Në mënyrë që të importojnë ose eksportojnë energji nëpërmjet cilit do kufi interkonektiv të Kosovës, Importuesit dhe Eksportuesit duhet të posedojnë (mbajnë) sasinë e kërkuar të DKI në atë kufi interkonektiv të vlefshme për orët e tregtimit. DKI mund të shiten në një treg sekondar.

Tregtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se alokimi i DKI bëhet në atë mënyrë që DKI e pashfrytëzuara (kur mbajtësi i së drejtës nuk njofton për shfrytëzimin e DKI në atë ditë ose kapacitetet e pa alokuara për atë ditë) do të vihen në dispozicion për Importuesit dhe Eksportuesit tjerë – parimi i aplikuar është se DKI nuk i japin mbajtësit të drejtën që ta ngrijë kapacitetin.


9. Njoftimi për Kontrata të Energjisë

Ky seksion do të përshkruajë pse dhe si Palët Tregtare do të njoftojnë OT për hollësitë e kontratave të tyre bilaterale (p.sh. Identitetin e Palës dhe Palës-homologe, datën/kohën e fillimit/përfundimit të kontratës dhe profilin e energjisë orë për orë (ose tjera) – por jo edhe detajet financiare).

Kontratat bilaterale që do të regjistrohen dhe do të përfshijnë detajet në përputhje me “Rregullat për Skemën Mbështetëse për Energjinë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Originës dhe Procedurat për Pranimin në Skemën Mbështetëse” dhe skemat tjera të adoptuara nga ZRRë.

OT do të mirëmbajë një regjistër të kontratave të tilla, të cilin OT dhe OST do ta përdorin për të kontrolluar në mënyrë të ndërsjellë vlefshmërinë e Nominimeve Fizike Një Ditë Para të energjisë për të siguruar një sistem të balancuar. Për këtë arsye, Njoftimet për Kontrata nuk do të pranohen pas Ditës së Tregtimit.

Si është theksuar në Seksionin 1, OT nuk do të bëjë barazimin financiar të energjisë së nominuar sipas kontratave bilaterale. OT është përgjegjës për barazimin e jo-balanceve të energjisë të cilat do të definojnë si ndryshim ndërmjet rrjedhave të energjisë së matur dhe sasive të nominuara.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 20 nga 41

PJESA II: Aktivitetet një Ditë Para dhe në Ditën e Tregtimit

10.Një Ditë Para: Parashikimi i Ngarkesës

Ky seksion përcakton detyrën e OST që të publikojë në ueb faqen e vet, në dobi të Palëve Tregtare, parashikimin e tij për ngarkesën në Ditën e Tregtimit (D) dhe vlerësimin e tij preliminar për humbjet në transmission. OST gjithashtu do të publikojë KTD për secilin kufi interkonektiv, Programin e Kompensimit për Ditën e Tregtimit (që përdoret për të “kthyer në formë të njëjtë” transferet e paqëllimshme interkonektive të cilat kanë ndodhur në Ditët paraprake të Tregtimit, në pajtim me procedurat ekzistuese të përcaktuara në Doracakun Operativ të ENTSO-E), dhe margjinën e kërkuar të Rezervës Operative (duke përfshirë lejimin e ndryshimeve që do të shkaktojnë BRE). Vëllimet e energjisë të nevojshme për Programin e Kompensimit dhe mbulimin e humbjeve në transmission do të blihen nëpërmes kontratave të përmbyllura nga ana e OST.

Kodi i Rrjetit e Obligon OST që të bëjë parashikime afatgjata, gjithashtu të publikojë ato, por këto nuk janë pjesë e Rregullave të Tregut – përveç njoftimit një muaj para të Gjeneratorëve me të cilët ka Marrëveshje për Shërbime Ndhimëse (MShN) për sasinë e Rezervës Sekondare të cilën e kërkon nga njësitë e tyre në muajin e ardhshëm. OST do të publikojë këtë shifër (Për këtë duhet njoftuar palët të cilat kanë kontrata me këta Gjenerator).

Gjithashtu, OSSH do të njoftojë OST për programin e prodhimit të planifikuar për të gjitha centralet e kyçura në rrjetin e shpërndarjes me fuqi nominale më të vogël se 5MW, dhe të Centraleve për Prodhimin e Energjisë (p.sh mullinj të me erë) me fuqi nominale më të vogël se 10MW duke u bazuar në të dhënat e ofruara për to sipas Kodit të Shpërndarjes.

11.Nominimet Fizike dhe Kontraktuese Një Ditë Para

11.1 Tregu Një Ditë Para


Aktualisht nuk do të ketë treg të centralizuar një ditë para. Këto procese lehtësojnë hyrjen në një treg eventual vullnetar në të ardhmen. Në Rregullat e ardhshme të reviduara të Tregut nuk parandalohet implementimi i Tregut Një Ditë Para.

11.2 Planifikimi një ditë para

11.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike dhe furnizimi konvencional

Në mënyrë që të planifikohet një sistem i balancuar dhe i sigurt, OST dhe OT ju nevojiten informata të caktuara nga Palët Tregtare. Ky seksion përcakton rolin e secilës Palë Tregtare në nominimin e parashikimit të vet të injektimit të energjisë në, ose tërheqjes nga ST:

- Për aq sa kërkohet sipas Kodit të Rrjetit, Gjeneratorët do të deklarojnë disponueshmërinë e secilës njësi gjeneruese, minus çfarëdo kapaciteti të mbajtur rezervë sipas një MShN. Ata do të njoftojnë OST për (çfarëdo ndryshimi) parametrat dinamik të

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 21 nga 41

njësive të tyre dhe kufijtë e operimit (kërkesë e Kodit të Rrjetit). Ata gjithashtu do të nominojnë programin e tyre të planifikuar të prodhimit të energjisë për secilën njësi dhe palët kontraktuese me të cilat kanë kontratë.

- Importuesit dhe Eksportuesit do të nominojnë rrjedhat e tyre të energjisë të propozuara të importit/eksportit në secilin kufi interkonektiv të shoqëruara me DKI që mbështesin këto rrjedha dhe palët kontraktuese me të cilat kanë kontratë.
- Furnizuesit do të nominojnë programin e kërkesës për energjinë e planifikuar për çdo orë të konsumatorëve të tyre (e rritur me çfarëdo FHSH të aplikueshëm) – FP mund të nominojë ndaras kërkesën për energji për Konsumatorët e Kualifikuar dhe ata të pa kualifikuar – dhe kontratat të cilat ata përdorin për t’i shërbyer kërkesës së tyre për energji.

11.2.2 Prodhimi i energjisë elektrike nga Burimet e ripërtërishme


Kodi i Rrjetit përcakton kërkesa të veçanta për lloje të caktuara të BRE, sipas madhësisë së tyre, nivelit të kyçjes dhe intermitencës së prodhimit të tyre. Si të tilla, të dhënat e kërkuara nga BRE ndryshojnë nga të dhënat e njësive gjeneruese të mëdha (termocentralet) që operojnë në sistem. “Rregullat për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Çertifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranimin në Skemën Mbështetëse” nuk e parandalojnë FP që të regjistrojë në emër të vetin centralet më të vogla të ripërtërishme duke zbritur këtë prodhim nga parashikimi i vet për ngarkesën.

12. Programi i balancuar dhe nominimet përfundimtare

Në pajtim me rregullat e ENTSO-E, Operatorët e Sistemit të Transmisionit duhet të dorëzojnë një program të balancuar sipas planit kohor të përcaktuar. Ky detyrim imponohet për Pjesëmarrësit individual në Treg nëpërmjet një obligimi që të nominojnë pozitat e balancuara në fazën një ditë para; nominimet e mbledhura duhet të jenë në balancë me parashikimet e tyre dhe të harmonizuara me nominimet e palëve kontraktuese.

Prandaj OST/OT do të përdorin informatat e ofruara për të verifikuar që Nominimet nuk kalojnë parametrat e kontratës dhe kërkesën/kapacitetin gjenerues të nominuar për të lejuar margjinën operuese, humbjet, importet dhe eksportet; që Nominimet e Gjeneratorit janë brenda parametrave dinamik të njësive të tyre dhe kufijve operativ; dhe se Nominimet e Interkonektorëve shoqërohen me DKI të miratuara. Nëse Nominimet e rrjedhave interkonektive në cilindo drejtim dhe cilindo kufi janë parashikuar të tejkalojnë kapacitetin interkonektiv, OST mundet që proporcionalisht të zvogëlojë Nominimet e tilla, nëpërmes Procedurave relevante të Tregut.

OST/OSSH gjithashtu do të verifikojnë nëse Nominimet janë të tilla që japin një balancë të përgjithshme të sistemit në secilën orë të ditës D, do të kontrollojnë kërkesën e përgjithshme për

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 22 nga 41

energji të Nominimeve të Furnizuesit kundrejt parashikimit të vet, do të publikojnë çfarëdo mospërputhje dhe do të kërkohet nga Palët Tregtare që të përmirësojnë mospërputhjet duke dorëzuar sërish Nominimet. Në veçanti, OST/OT do të identifikojnë çfarëdo jo-balanci të mundshëm në sistem dhe do të njoftojnë Furnizuesit për mungesën apo tepricën e paraqitur për cilëndo periudhë të furnizimit ose për problemet në sistem. Pritet që Furnizuesit dhe Importuesit të ndërmarrin veprime përkatëse: Importuesit të kërkojnë importe afatshkurta të energjisë për të mbuluar mungesën (për aq sa ka në dispozicion KDI në atë ditë në ndonjë interkoneksion), dhe Furnizuesit të dorëzojnë Nominimet e përmirësuara për kërkesën për energji dhe/ose aktivizimet e kontratave. Po ashtu, në kohën kur ka tepricë të prodhimit p.sh. kur shumica e prodhimit minimal në të gjitha centralet elektrike të nominuara tejkalon kërkesën e konsumatorëve, Eksportuesit do të duhet të kërkojnë eksporte afatshkurta të energjisë për të zgjidhur problemin e tepricave (nëse ende kanë në dispozicion KDI në ndonjë interkoneksion) dhe Gjeneratorët ose Furnizuesit duhet të dorëzojnë Nominimet e reviduara të programeve kontraktuese.


Për një periudhë të definuar kohore një ditë para (deri në Mbylljen e Portës) Furnizuesit mund të vazhdojnë të dorëzojnë Nominimet e përmirësuara të Kërkesës për energji; Gjeneratorët të dorëzojnë Nominimet e përmirësuara për disponueshmërinë dhe prodhimin për njësi; dhe Importuesit dhe Eksportuesit të dorëzojnë Nominimet e përmirësuara të rrjedhave interkonektive. Me Mbylljen e Portës (~15:30 një ditë para D-1) këto Nominime bëhen përfundimtare.

Nominimet përfundimtare do të përdoren si bazë për matjen e jo-balancit të Tregtarëve (ndryshimi ndërmjet energjisë së matur dhe asaj të Nominuar/Instrukturuar). Kontratat bilaterale për energji të Tregtarëve do të barazohen – ‘sipas nominimit’ – jashtë Tregut (pritet që kjo do të jetë e bazuar në Nominimet e Furnizuesve).

13. Kontraktimi dhe Përcaktimi i Çmimeve për Shërbimet Ndhmëse

Shërbimet Ndhmëse janë shërbime të OST të nevojshme për menaxhimin dhe operimin e sigurt të sistemit elektrtoenergjetik dhe që blihen nga OST në emër të të gjithë shfrytëzuesve të sistemit sipas Nenit 13 të Licencës së OST. Shërbimet ndihmëse përfshijnë:

- Mbështetjen me MVAR dhe rregullimi i Tensionit (obligative për të gjitha njësitë të cilat janë në pajtim me Kodin e Rrjetit);
- Startimin nga Zero (Obligative për njësitë gjeneruese të zgjedhura dhe të kualifikuara);
- Rregullimin e frekuencës, duke ofruar rregullimin primar (obligativ për të gjitha njësitë gjeneruese sinkrone); dhe
- Rezervën Sekondare dhe Terciare, të ofruar sipas marrëveshjeve për ShN nga burimet e kualifikuara (këto janë menduar të mbulojnë daljen e pa planifikuar nga sistemi të një njësie gjeneruese në Kosovë).

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 23 nga 41

Të gjitha shërbimet administrohen nga Kodi i Rrjetit (posaçërisht seksionet e Kodit të Rregullimit të Frekuencës, Kodit të Rregullimit të Tensionit dhe Kodit të Rasteve të Paparashikuara), por vetëm shërbimi i fundit është me interes për Rregullat e Tregut.

Marrëveshja e ShN për Rezervë Sekondare është një kontratë bilaterale ndërmjet OST dhe Palës Tregtare, me të cilën Pala pajtohet që të rezervojë një sasi të caktuar të kapacitetit në njësitë e caktuara gjeneruese, në formë të pagesës për rezervim të kapacitetit të ShN, që paguhet në baza mujore në kohëzgjatjen e kontratës. Zakonisht, OST bën specifikimin një muaj para të sasisë së kapacitetit që do të rezervohet për muajin pasues, duke u bazuar në kërkesën maksimale për atë muaj. Për tu kualifikuar për pagesë, kapaciteti i rezervuar në këtë mënyrë nuk mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër dhe duhet të vihet në funksion automatikisht, p.sh. nëpërmes një sinjali nga rregullatori frekuencë- fuqi i OST, brenda një kohe të caktuar.

Marrëveshja e ShN për Rezervën Terciare është një kontratë për ofrimin e prodhimit shtesë ose reduktimit të ngarkesës, brenda 15 minutave nga instruksioni/udhëzimi për dispeçim të dërguar nga qendra dispeçerike e OST, me qëllim të lirimit të rezervës Primare dhe Sekondare³.

Sasitë minimale të Rezervës Sekondare dhe Terciare të cilat OST duhet ti blejë si dhe proporcioni me të cilin këto rezerva duhet të ofrohen nga burimet e brendshme të Kosovës përcaktohen në Doracakun Operativ të ENTSO-E.

Kostoja e rezervimit të kapacitetit për ShN do të mbulohet nga OST nëpërmes tarifave të rregulluara për shërbimet e rrjetit. Çfarëdo energjie e programuar për Rezervën Sekondare dhe Terciare do të konsiderohet se është injektuar në sistem dhe do të trajtohet si përgjigje në Instruksionin e MB dhe barazohet sipas Mekanizmit Balancues.

Kontraktimi i Shërbimeve ndihmëse nga OST në mënyrë eksplicite rregullohet me Nenin 13 të licencës së tij.


14.Mekanizmi Balancues: Një Ditë Para dhe në Kohë Reale

Ky seksion përshkruan aktivitetet e Mekanizmit Balancues, mjeti kryesor me të cilin OST do të menaxhojë dhe balancojë sistemin në kohë reale.

Pas marrjes nga OT të Ofertave për blerje të energjisë dhe Ofertave për shitje të energjisë në MB, OST do të zgjedh dhe pranojë nga Palët Ofertat për Mekanizmin Balancues:

- (i) Që të bëjë balancimin e sistemit si nga aspekti nacional po ashtu dhe në raport me sistemet e OST fqinje;
- (ii) Që të sigurojë furnizimin e sigurt, të besueshëm dhe ekonomik me energji elektrike për të gjithë konsumatorët

³ Kodi i Rrjetit përcakton se Rezerva Terciare mund të ofrohet nga Njësite Gjeneruese ose ngarkesat e dispeçueshme në sistemin elektroenergetik të Kosovës.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 24 nga 41

- (iii) Që t'i jep prioritet dispeçimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë si kërkohet me Skemën Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme dhe Ligjin për Energjinë Elektrike;
- (iv) Të përmbush të gjitha objektivat tjera të Ligjit për Energjinë Elektrike (2010).

Kodi i Dispeçimit si pjesë e Kodit të Rrjetit përshkruan procesin të cilin OST e përdorë për të balancuar sistemin duke përdorur Mekanizmin Balancues dhe Marrëveshjet për Shërbimet Ndhimëse në mënyrë që të përmbush obligimet e veta nga licenca që të operojë sistemin elektroenergetik në mënyrë eficiente, ekonomike dhe të koordinuar.


Në pajtim me Politikën P2 të ENTSO-E për Programim dhe Llogaritje, OST dorëzon te Koordinatorin e Bllokut Rregullues/Qendra Koordinative, programin e tij të planifikuar të prodhimit, parashikimin e kërkesës dhe neto programin e shkëmbimit – duke përfshirë Programin eventual të Kompensimit. Me pranimin e programit të konfirmuar të shkëmbimit OST do të njoftojë Importuesit dhe Eksportuesit për të DKI e tyre tashmë të konfirmuara për importin/eksportin (të cilat mund të jenë zvogëluar nga OST për të menaxhuar çfarëdo kongjestioni të mundshëm) dhe do të njoftojë secilin Gjenerator për Pozitën e Instruktuar të çdo njërës njësi të tyre për secilën orë të Ditës së Tregtimit.

Në (ose afër) kohë reale, OST mund të dërgojë Instruksione të Dispeçimit për të gjitha Palët Tregtare duke u bazuar në njohuritë e tij për kushtet aktuale apo të pritura, ose pas pranimit të azhurnimeve ose revidimeve të të dhënave dinamike të Gjeneratorit, devijimet e matura nga programi i shkëmbimit neto ose të dhënat e tjera të ndërlydhura me sistemin. Këto Instruksione të dispeçimit (së bashku me Nominimet e tyre dhe çfarëdo Programi Instruksionesh për MB) bashkërisht do të përcaktojnë Pozicionin e Instruktuar e të gjitha Palëve Tregtare, kundrejt të cilit do të kalkulohej jo-balancet e tyre (nëse ka).

Nëse OST programon një Njësi Gjeneruese ndryshe nga Pozita e saj e Nominuar, OST do të jep një Instruksion MB për të “rritur” ose “zbritur” prodhimin e një njësie të caktuar në nivelin e caktuar, atëherë ky udhëzim dispeçimi do të konsiderohet i vlefshëm ashtu si është përcaktuar në Kodin e Rrjetit. Ky instruksion krijon një kontratë ndërmjet OST dhe Gjeneratorit, e cila do të barazohet sipas çmimit të ofertës së Gjeneratorit për njësinë. Parimi i njëjtë zbatohet për Furnizuesit të cilët marrin pjesë në MB me ngarkesë të dispeçueshme: në këtë rast një Instruksion ‘rritës’ i MB është të reduktojë ngarkesën në nivelin e caktuar, dhe anasjelltas për ‘zbritje’.

15. Aktivitetet një ditë para

Gjeneratorët dhe Furnizuesit dorëzojnë ofertat për blerje të energjisë dhe ofertat për shitje të energjisë dhe çmimet në Mekanizmin Balancues: çmimi i ofertës për blerje është çmimi me të cilin ata do të paguajnë për energjinë e furnizuar për ta nga OST (reduktimin e prodhimit të Njësisë Gjeneruese të tyre ose duke rritur ngarkesën nga ana e furnizuesit me pranimin e një Instruksioni ‘zbritës’ në MB nga OST); dhe çmimi i ofertës për shitje është çmimi me të cilin ata

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 25 nga 41

do të furnizojnë energjinë në sistem (rritjes së prodhimit nga ana e gjeneratorit ose reduktimit të ngarkesës nga ana e furnizuesit) me pranimin e një Instruksioni ‘rritës’ në MB

Pasi që Dizajni i Tregut kërkon që çmimet e ofertave të përdoren në përcaktimin e çmimeve të jo-balancit dhe barazimit, pjesëmarrja në MB është obligative për të gjithë Gjeneratorët dhe Furnizuesit dhe çmimet e ofertave të dorëzuara në D-1 nuk mund të ndryshohen gjatë Ditës së Tregtimit. OST/OT do të publikojë të gjitha të dhënat e ofertave.

OT do të regjistrojë mënyrën e ofertimit në Mekanizmin Balancues për të siguruar që të mbetet konsistent me principet themelore të furnizimit dhe kërkesës për energji në tregun e Kosovës. OT do të informojë ZRrE dhe Komisionin për Konkurrencë në Kosovë për çdo sjellje jokonkurrencte në tregun e energjisë elektrike, sipas kushteve të Ligjit për Energji.

Pjesëmarrja e Importuesit dhe Eksportuesit në MB lejohet në përputhje me kërkesat e ENTSO-E. Mundësimi i pjesëmarrjes së Importuesve dhe Eksportuesve në MB në praktikë do të varet nga ekzistimi i rregullave të përbashkëta të publikuara për harmonizimin e nominimeve brenda ditës (intra day) të rrjedhave interkonektive ndërmjet OST dhe për konfirmimin e tyre në nivel të Koordinatorit të Bllokut Rregullues apo nivelit më lartë nëse është e nevojshme. Kjo gjithashtu varet nga disponueshmëria e KTD në kufirin relevant interkonektiv.

Pas Mbylljes së Portës, OST do të fillojë të ekzekutojë Ofertat në MB për të përmbushur obligimin e tij për të menaxhuar sistemin.


16. Aktivitetet në ditën D

Në kohë reale OST do të shfrytëzojë MB për të mirëmbajtur balancin e energjisë në sistem në pajtim me rrethanat e krijuara.

Menaxhimi i Sforcimeve

Mund të paraqiten situata (p.sh. gjatë ndaljeve të planifikuara në transmision të përcjella me ndalesa të detyrueshme, ose ndalesa të planifikuara ose të detyrueshme në sistemin e Shpërndarjes) kur një pjesë e rrjetit nuk mund të furnizohet nga sistemi kryesor interkonektiv. Në rrethana të tilla OST dhe/ose OSSH duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar balancin e sistemit. Kjo mund të përfshijë shkyçjen e ngarkesës dhe ndaljen e njërive prodhuese të kyçura në rrjetin e shpërndarjes në pjesën e ndikuar të rrjetit, dhe instruksionet nga OST për njësitë gjeneruese që të reduktojnë prodhimin.

Veprimet e tilla do të ndërmerren si instruksione të MB. Për këtë arsye do të jetë e nevojshme që të përcaktohen çmimet e përshtatshme të ofertave për reduktim të ngarkesës si dhe çmimet e nevojshme për përshtatjen e prodhimit të njërive gjeneruese.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 26 nga 41

Kur nuk disponohet me Oferta të mjaftueshme për menaxhimin e sforcimeve, kjo mund të shpie në mbingarkesën e sistemit. Në këto rrethana, duhet të jepet një instruksion emergjent në pajtim me Kodin e Rrjetit për reduktimin e ngarkesës.

17. Kalkulimi i Jo-Balanceve të Energjisë

Ky seksion përshkruan se si kalkuloohen jo-balancet e energjisë të Palëve Tregtare.

Në ditën e 5^{te} të punës pas çdo Dite të Tregtimit, OST dhe OSSH do t'i dërgojnë OT të gjitha të dhënat e nevojshme për barazim:

- OST do të dërgojë shënimet për Pozicionin e Instrukuar të integruar (në MWh) të secilës njësi në secilën orë të Ditës së Tregtimit.
- Për një Furnizues pjesëmarrës në MB, OST ose OSSH (sipas rastit) do të dërgojnë të dhënat e agreguara të matjeve dhe kohën e reduktimit të ngarkesës.
- OST ose OSSH i dërgojnë leximet e njehsorëve për çdo orë të Ditës së Tregtimit për të gjitha pikat e matjes së sistemit (Njësitë Gjeneruese dhe Konsumatorët e Kualifikuar me njehsor interval të kyçur në ST dhe SSh, të gjitha linjat interkonektive, dhe shumën e njehsorëve në kufirin ST:SSh)

Me zhvillimin e konkurrencës në furnizim, kërkesa për energji e konsumatorëve të kualifikuar me njehsor jo-interval duhet të përcaktohet me saktësi dhe t'i dërgohet OT për qëllime të menaxhimit të procesit të barazimit.


Jo-Balancet e Palëve Tregtare

Integrimi matematik i Pozitës së Instrukuar të Palës Tregtare gjatë secilës periudhë të barazimit prodhon një vlerë në MWh. Gjithashtu, derisa matjet operative ofrojnë të dhënat bazë të MW, Matja për Barazim është e dizajnuar që të ofrojë të dhëna në MWh të alokuara për Periudhat individuale të Barazimit.

Në rast se ndonjë e dhënë mungon ose është e pasaktë, OST ose OSSH do të dërgojnë vlerësimin më të mirë të vlerës së vërtetë me aplikimin e çfarëdo përmirësimi pasues për të rrikalkuluar jo-balancin e energjisë së secilës Palë Tregtare. Kërkesa e Konsumatorëve në sistemin e Shpërndarjes të FP nuk matet e gjitha në intervale (për orë), dhe do të kalkulohet matematikisht si:

$$FP_{ST:SSh} = \sum \text{Ngarkesës në kufirin TS:SSh} + \{ \sum \text{Prodhimi i Gjeneratorëve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes} \} - \{ \sum \text{Ngarkesës së KKT të kyçur në rrjetin e shpërndarjes} \}.$$

Ngarkesa e KKT është ngarkesa e konsumatorëve të kyçur në Sistemin e Shpërndarjes të cilët janë transferuar te një furnizues konkurrent dhe të gjitha të dhënat e matjes janë rritur me FHSH relevant. Si është shpjeguar më lartë të gjitha elementet e këtij kalkulimi do të janë në MWh.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 27 nga 41




Figura 3: Integrimi i Pozitës së Instruktuar për Barazim


Energjia aktuale e secilës Palë Tregtare në secilën orë të D do të mbledhet në llogaritë e tyre (duke trajtuar prodhimin dhe kërkesën për energji ndaras). OT do të kalkulojë dhe regjistrojë jo-balancin e energjisë të secilës Palë Tregtare në secilën orë si ndryshim ndërmjet energjisë së matur në orën e caktuar dhe pozitës së Instruktuar (ose Nominuar nëse nuk ka ndryshuar) në atë orë – përsëri duke trajtuar prodhimin dhe kërkesën për energji ndaras. Është roli i OST dhe OSSH që me kohë t’i dërgojnë OT shënime të sakta për barazim, ndërsa është përgjegjësi e secilës Palë Tregtare që të sigurojnë që vlerat e mbledhura në llogaritë e energjisë të Palëve Tregtare përkatëse të jenë të sakta. Secila Palë Tregtare ka mundësi që të rishikojë të dhënat e matura (ti miratojë apo modifikojë të dhënat), dhe të jep pëlqimin që të dhënat e dorëzuara tek OT të përdoren për realizimin e kalkulimeve të Barazimit. Ky pëlqim nuk ndikon në të drejtën e palës që më vonë të kontestojë të dhënat e njehsorit apo të paraqes ndonjë kontest sipas kodit relevant të matjes.

Jo-Balanci i Gjenerimit nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë Elektrike (BRE)

OT do të regjistrojë vëllimin e energjisë së prodhuar nga BRE sipas MBE në përputhje me rregullat për Skemën Mbështetëse për Energji të Ripërtërishme (SMER). Alokimi i kostove të barazimit të jo-balanceve të gjeneratorëve me BRE qeveriset nga “Rregullat për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranimin në Skemën Mbështetëse”. Kjo rregull specifikon që 25% e këtyre kostove për menaxhimin e jo-balanceve të shkaktuara nga energjia e matur e gjeneratorit me BRE minus energjia e tij e nominuar në cilëndo orë do të mbulohet nga Gjeneratori, dhe pjesa e mbetur do t’i ngarkohet Fondit për Energji të Ripërtërishme të themeluar për të mbështetur tarifatat nxitëse.

Jo-Balanci i Operatorit të Sistemit

Çfarëdo jo-balanci në Kosovë i krijuar nga dështimi i një importi apo eksporti të pritur do të ketë një gabim të përputhshëm në një shtet fqinjë. Programet e kompensimit të nxjerra në pajtim me rregullat e ENTSO_E do të sigurojnë që gabimi të përmirësohet gjatë javës pasuese. Nuk do të jetë e mundur që të identifikohen gabimet e krijuara nga Importuesit dhe Eksportuesit individual. Rrjedhimisht, rezultatet e çfarëdo Tregtimi Interkonektiv do të konsiderohen në tërësi për qëllime të barazimit të jo-balanceve.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 28 nga 41

Çfarëdo devijimi i rrjedhave interkonektive nga programi i shkëmbimit i shkaktuar nga dështimi i tregtive interkonektive ose nga ndonjë jo-balanc brenda Kosovës i cili nuk është korrigjuar në kohë reale do të trajtohet si jo-balanc i sistemit.

OT do të kalkulojë jo-balancin e sistemit për secilën orë (ndryshimin ndërmjet të dhënave aktuale të matura të njehsorëve të interkonektorëve dhe neto programit të shkëmbimit). Kjo do të përcaktojë nëse sistemi ka qenë i balancuar, me tepriçë (eksporti i paqëllimshëm) ose me mungesë (importi i paqëllimshëm). OT do të regjistrojë sasinë relevante të energjisë që do të kompensohet në formë të njëjtë në javën pasuese nga Programi i Kompensimit të OST⁴.

Humbjet në Transmision

Si është theksuar më lartë, OST do të jetë përgjegjës për blerjen e energjisë për mbulimin e vëllimit të parashikuar të humbjeve. Në fazat fillestare të implementimit të këtij dizajni, OST do të duhet të bëjë kontrata opcionale për të siguruar disponueshmërinë e kapacitetit të nevojshëm për sasinë e energjisë të nevojshme në ditën e realizimit.

Dallimi i parashikimit të humbjeve nga ana e OST-së me humbjet e llogaritura me vlerat matëse do të konsiderohet si jo-balanc i OST-së.


18.Kalkulimi i Çmimit të Jo-Balancit

Ky seksion përshkruan se si përcaktohet çmimi i Jo-Balanceve të Energjisë të Palëve Tregtare.

Metodologjia për Kalkulimin e Çmimit të Jo-Balancit do të përshkruhet në hollësi në Rregullat e Tregut. Megjithatë, ekzistojnë disa parime themelore të cilat OT do t'i aplikojë për cilëndo nga metodat e zgjedhura:

- Do të jetë i drejtë dhe transparent aq sa është e mundur dhe kompleks vetëm sa është e nevojshme;
- Do të bazohet në çmimet e ofertave të Palëve Tregtare dhe do të monitorohet nga ZRRë;
- Çmimet e jo-balancit janë menduar të jenë motivuese ashtu që Pala Tregtare ti përmbahet programit të nominuar dhe të reflektojnë te Pala Tregtare koston e balancimit të sistemit. Dihet se jo-balancet zakonisht janë të paqëllimshme dhe kërkohet që çmimi i jo-balancit të mundësojë që në MB të ketë fondet e disponueshme për të paguar energjinë e nevojshme për aktivitetet balancuese të OST-së.

⁴ (si përcaktohet në Doracakun Operativ të ENTSO-E, Politika 2, seksioni C-S1) nga Programi i Kompensimit të OST

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 29 nga 41

- Dizajni i Tregut ka për qëllim të inkurajojë sjelljen e mirë në Treg. Prandaj, në rast se një Palë Tregtare konsiderohet të jetë shumë shpesh apo vazhdimisht në jo-balanc (duke rrezikuar në këtë mënyrë sistemin) OST/OT mund të kërkojë nga ZRrE të marrë masa të nevojshme ndaj Palës përkatëse duke përdorur fuqinë e tij sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (2010).

Gjeneratorët e Ripërtërishëm të pranuar në Skemën Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme (SMER) do të jenë përgjegjës vetëm për 25% të kostos së jo-balancit të tyre (Neni 19.3 i versionit në gjuhën shqipe të SMER). Pjesa e mbetur do të rikthehet nga Fondi për Energjinë e Ripërtërishme.

19. Barazimi


OT do të udhëheq procedurën për barazimet e Tregut për secilën Ditë të Tregtimit, jo më vonë se pas 5 ditë pune.

Me zhvillimin e konkurrencës do të themelohet një proces alternativ për të siguruar që procesi i barazimit do të zbatohet në vazhdimësi dhe në mënyrë të drejtë, për të përcaktuar me saktësi kërkesën për energji të konsumatorëve të cilët nuk kanë njehsorë interval. Për këtë lloj të konsumatorëve do të përdoret profilizimi i kërkesës për energji. Për grupin e konsumatorëve me modele të ngjashme të kërkesës për energji do të përdoret një diagram standard i kërkesës për energji i përcaktuar me përdorimin e të dhënave historike. Diagrami i konsumit për një interval kohor të barazimit (një orë) nxirret duke u bazuar në vlerësimin e kërkesës vjetore për energji të konsumatorit. Gjatë kohës, dizajni mund të zhvillohet për të siguruar që edhe për njehsorët jo-interval të ruhen karakteristikat e profilit si kategoria e konsumatorëve dhe vlerësimi i kërkesës vjetore për energji. Do të zhvillohet një procedurë për metodologjinë e profilit – krijimi dhe përdorimi i profileve.

Kontratat bilaterale ndërmjet Palëve Tregtare: si është theksuar më lartë barazohen (paguhen) ‘jashtë Tregut’. Nëse kërkohet nga Palët kontraktuese OT do t’u ofrojë informata për vëllimin e energjisë së nominuar nën secilën kontratë dhe pjesën (nëse ka) e jo-balancit të energjisë së Palëve të alokuar sipas kontratës. Gjithashtu, nëse kërkohet, do të ofrojë informata për disponueshmërinë e deklaruar dhe aktuale të Njësive Gjeneruese.

Si tregohet në Figurën 4, Kontratat bilaterale ndërmjet OST dhe Palëve Tregtare paraqiten në dy forma:

- Tarifat (pagesat) për disponueshmërinë e kapacitetit të rezervës për ShN sipas marrëveshjeve për ShN (kryesisht Rezerva Sekondare dhe Terciare) dhe formave tjera alternative paguhen në baza mujore sipas kontratës për ShN ‘jashtë Tregut’.
- Instruksionet e MB për Gjeneratorët dhe Furnizuesit që marrin pjesë në MB – paguhen në bazë të çmimit të ofertave të Palës Tregtare: paguhen nga Llogaria e MB të OST në

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 30 nga 41

Llogarinë e Palës Tregtare në rast se instruksioni është rritës në MB, dhe anasjelltas kur instruksioni është zbritës.

Pagesat/detyrimet e Energjisë së Jo-Balancit (paguar me çmim të Jo-Balancit) – Nëse Pala Tregtare ka tepriçë të energjisë (dmth. Liferon energji shtesë në sistem), do të paguhet nga llogaria e MB të OST dhe anasjelltas nëse Pala ka mungesë (dmth. merr energji shtesë nga sistemi) do të paguaj.

Lidhur me skemën Mbështetëse për Energji të Ripërtërishme (SMER) – OT do të njoftojë FP për vëllimin e energjisë së prodhuar nga BRE dhe të atribuar te FP sipas MBE e përcaktuar sipas Nenit 14 ose Nenit 15 të SMER.

Në pajtim me Skemën Mbështetëse për Energji të Ripërtërishme (SMER), kushtëzuar me disponueshmërinë e mjeteve në Fondin për Energji të Ripërtërishme, OT do të barazojë cilëndo faturë të ngritur nga Furnizuesi Publik lidhur me shpenzimet e shkaktuara nëpërmjet skemës, duke paguar këtë shumë nga Fondi për Energji të Ripërtërishme.





Figura 4: Kontratat e Mekanizmit Balancues

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 31 nga 41

20. Detyrimet

Ky seksion përshkruan pagesat apo detyrimet të cilat do të bëhen ndërmjet Palëve të Tregut. Në vijim janë dhënë llojet e detyrimeve që do të përdoren në përputhje me procedurat dhe tarifrat që do të miratohen nga ZRRrE:

Detyrimet për Rrjetin e Transmisionit (DRr)

OST do të kalkulojë dhe publikojë detyrimet e DRr për Gjeneratorët (aktualisht zero) dhe detyrimet e DRr për Furnizuesit (ndaras për 110kV dhe për 220kV e më lartë) të menduara për realizimin e të hyrave të lejuara për Rrjetin e Transmisionit.

Detyrimet për Operatorin e Sistemit (DOS)

OST do të kalkulojë dhe publikojë tarifrat e DOS për Gjeneratorët dhe tarifrat e DOS për Furnizuesit të menduara për realizimin e të hyrave të lejuara të OS, dhe bazuar në parashikimin e OST për prodhimin e përgjithshëm vjetor të Gjeneratorëve dhe konsumit të përgjithshëm vjetor të Furnizuesve. Këto tarifa do të zbatohen për llogaritë e energjisë të secilës Palë Tregtare (ndaras për Gjeneratorët dhe Furnizuesit) për të kalkuluar DOS dhe do të faturohen në baza mujore me një rikonsilim në fund të vitit.

Ky detyrim do të përfshijë të hyrat e lejuara për pagesën e humbjeve në transmision.

Detyrimet për Operatorin e Tregut (DOT)


OT do të kalkulojë dhe publikojë tarifrat e DOT për Gjeneratorët dhe tarifrat e DOT për Furnizuesit të menduara për realizimin e të hyrave të lejuara të OT, dhe bazuar në parashikimin e OST për prodhimin e përgjithshëm vjetor të Gjeneratorëve dhe konsumit të përgjithshëm vjetor të Furnizuesve. Këto tarifa do të zbatohen për llogaritë e secilës Palë Tregtare (ndaras për Gjeneratorët dhe Furnizuesit) për të kalkuluar DOT dhe do të faturohen në baza mujore me një rikonsilim në fund të vitit.

Detyrimet / pagesat e Mekanizmit Balancues

OT do të faturojë secilën Palë Tregtare për neto pagesat/detyrimet e MB në baza mujore për jo-balancet e tyre të energjisë.

Skema Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme (SMER)

OT do të njoftojë FP për vëllimin e energjisë nga BRE të matur në secilin muaj në mënyrë të veçantë bazuar në Nenin 6 të SMER.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 32 nga 41

OT do të faturojë Palët Tregtare sipas tarifave të caktuara nga ZRrE në pajtim me Nenin 18 të SMER dhe paratë do të depozitohet në Llogarinë e Fondit për Energjinë e Ripërtërishme.

Varësisht disponueshmërisë së mjeteve në Fondin për Energjinë e Ripërtërishme, OT do të paguajë FP, nga Llogaria e Fondit për Energjinë e Ripërtërishme e OST, që do të mbulojë koston shtesë për energjinë e blerë nga BRE, si është përcaktuar në Nenin 16 të SMER.

Llogaria e parasë së gatshme e OST për MB

Llogaria e parasë së gatshme për MB pritet të luhatet rreth zeros, varësisht se sa të sakta janë Palët Tregtare në nominimet dhe parashikimet e tyre – qo do të jetë një tregues i disiplinës së mirë të tregut. Megjithatë, nëse një njësi e madhe bie, vëllimi i rrjedhës së parasë do të mund të bëhet i madh. Gjithashtu, varësisht se si Furnizuesit nominojnë prodhimin e kontraktuar për të përmbushur kërkesën e konsumatorëve⁵, mund të ndodhë që MB të financojë vazhdimisht për rritjen e prodhimit të njërive me kosto të lartë dhe zvogëlimin e prodhimit të atyre me kosto më të ulët – që ka efekt në koston e Tregut nga aspekti i minimizimit të jo sigurisë së furnizimit në planin afatgjatë. Duke marrë parasysh që barazimi përfundimtar do të jetë aktivitet mujor, do të krijohet një llogari shtesë e rrjedhjes së parasë që do të rikthejë neto të hyrat nga kjo llogari e palëve tregtare në proporcion me madhësinë e tyre ose anasjelltas, palët tregtare do të ngarkohen me detyrime shtesë kur ka mungesë në llogari.

21.Faturat

Ky seksion përshkruan planin kohor dhe procedurat të cilat do të zbatohen nga OT në lëshimin e faturave mujore për pagesa/detyrime për Palët Tregtare.

Në ditën e 6 të punës të secilit muaj, OT do të përgatisë një faturë për secilën Palët Tregtare, duke ndarë secilin element të detyrimit dhe vlerën totale që duhet paguar të shoqëruar me një raport të vëllimeve të tyre të matura për muajin paraprak kalendarik (shuma e të dhënave të dorëzuar nga Pala Tregtare për secilën ditë të Barazimit).

Vlera totale e faturës do të paguhet në ditën e 5 pasuese. Bashkërisht me mekanizmat tjerë të detyrimeve në sektorin elektroenergetik të Kosovës, fatura duhet të paguhet dhe çfarëdo kontesti rreth saktësisë trajtohet më vonë. Kjo parandalon pamundësinë e OT të paguajë faturat e palëve të tjera të tregut.

⁵ Koncepti thotë se gjenerimi do të dispeçohet sipas “informatave për çmimin e energjisë” që nënkupton zgjedhjen e njërive me kosto më të ulët të gjenerimit, pavarësisht nga efekti që kjo do të ketë në besueshmërinë e njërive jo-fleksibile sikurse Kosova A

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 33 nga 41


Nëse një Palë Tregtare ka ndonjë paqartësi lidhur me ndonjë element të faturës, ajo mundet menjëherë të kërkojë sqarim nga OT apo këtë ta bëjë më vonë. Si është theksuar më poshtë, Pala Tregtare dhe OT duhet të provojnë që të zgjidhin paqartësitë ndërmjet tyre por nëse ky proces dështon çështja mund të ngritet si Kontest të cilin Palët mund të kërkojnë ta zgjedhin sipas procedurave përkatëse për zgjidhje të Kontesteve, varësisht nga ajo nëse çështja në fjalë bie nën Kodin e Rrjetit, Kodin (et) e Matjes ose Rregullat e Tregut. Nëse një Vendim për Kontestin përcakton se ka pasur një gabim në faturën për detyrimin e një Pale Tregtare ose në vlerën e matur në një apo më shumë periudha të barazimit, OT do të bëjë korrigjimin e faturave për të gjitha palët, që mund të përfshijë rikalkulimet e barazimit për periudhat relevante dhe çfarëdo periudhë pasuese. Korrigjimi i tillë do të paraqitet si një rresht shtesë në faturën e Palës në ciklin e ardhshëm të Faturimit.

Si pjesë e procesit të faturimit, pjesëmarrësve do të ju ofrohen informata të mjaftueshme mbështetëse ashtu që atyre t'u mundësohet miratimi i rezultateve të barazimit.

Në rast mos pagese të ndonjë Fature, OT do të përdorë garancionet e sigurimit të ofruara sipas Seksionit 23: Kërkesat për garancionin financiar për të mbuluar borxhet e pa paguara.

22. Kontestet

Kontestet do të trajtohen sipas Kodit relevant (psh. çështjet për njehsorët dhe vëllimet e matura sipas KM dhe KMSH; për programin e gjeneratorit dhe dispeçimin sipas Kodit të Rrjetit, etj). Rregullat e Tregut duhet të konsiderojnë vetëm kontestet për Aderimin, Barazimin, Faturimin dhe Detyrimet. Palët që u nënshtrohen Rregullave të Tregut duhet të provojnë që në instancë të parë mes tyre të zgjidhin kontestet dhe nëse kjo nuk ka sukses ato mund të pajtohen që çështja ti referohet për zgjidhje një ekspertit. Përfundimisht, çdo Palë mund të ngritë çështjen që ajo të zgjidhet sipas procedurës formale të ZRrE për Zgjidhjen e Kontesteve.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 34 nga 41

PJESA III: QEVERISJA

23. Kërkesat për garancion financiar

Në lidhje me Palët e Tregut, Ligji për Energjinë Elektrike (2010) i obligon të gjithë Gjeneratorët dhe Furnizuesit e licencuar që të ofrojnë një garancion financiar që të mbulojnë transaksionet në treg.

Për arsye të kohës së nevojshme për marrjen dhe procesimin e të dhënave, pagesa e faturave për barazimin e detyrimeve për Intervale kohore mund të merr kohë më shumë se një muaj. Në periudhën kohore kur fatura duhet të paguhet, mund të ndodhë që Pjesëmarrësi në Treg të mos jetë në gjendje të bëjë pagesën sipas faturës. Pagesat e pambuluara duhet të mbulohen nga Palët Tregtare sipas proceseve të përcaktuara në Seksionin 21. Faturat.

Për të reduktuar rrezikun e borxheve të pa paguara të cilat do të ndikonin negativisht në rrjedhat e tjera të parasë sipas Rregullave të Tregut aplikohen forma tjera të sigurisë si llogari garantuese të parasë së gatshme, Letrat e Kreditit ose Garancionet Bankare.

OT periodikisht do të vlerësojë nivelin e borxhit që mund të shkaktojë gjatë kohës së barazimit dhe të njoftojë Pjesëmarrësit për nivelin e kërkuar të sigurisë e cila duhet të ofrohet. Procesi detal për përcaktimin e nivelit të vlerësuar të borxhit do të përcaktohet në Procedurat e Tregut të referuar në këtë seksion.


Ky Seksion gjithashtu do të specifikojë procedurat për rritjen apo zvogëlimin e nivelit të garancioneve financiare. Dështimi nga ana e Pjesëmarrësit të Tregut që të dorëzojë garancionin financiar ose të ngritë nivelin e tij kur kërkohet do të konsiderohet si shkelje e Rregullave të Tregut.

24. Raportimi dhe Informatat e Tregut

Ekziston një detyrë e përgjithshme për OT që në baza periodike dhe në hollësi të raportojë se çka është duke ndodhur në treg. Të gjitha informatat relevante për tregun do të publikohen në ueb faqen e OST (informatat e ndjeshme komerciale do të publikohen në një seksion të sigurt të mbrojtur me fjalëkalim). Disa informata do të publikohen në tërësi, kurse të dhënat konfidenciale mund të përmbliidhen ose bëhen anonime për të ruajtur konfidencialitetin komercial dhe në të njëjtën kohë njofton pjesëmarrësit tjerë të Tregut.

OT do të mirëmbajë një arkiv të sigurt të të gjitha vëllimeve/çmimeve të Barazimit, etj, për 5 vjet, ku sipas kërkesës do të kenë qasje të gjithë Tregtarët dhe palët e interesit.

OST ngjashëm do të mirëmbajë një arkiv të të gjitha instruksioneve për programim/dispeçim dhe instruksioneve të MB si kërkohet sipas Kodit të Rrjetit.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 35 nga 41

25. Gjendjet Emergjente në Sistem

Procedurat me të cilat OST deklaron një gjendje emergjente në sistem përcaktohen në Kodin e Rrjetit, dhe asgjë në Rregullat e Tregut nuk do t'i mbisundojë këto. Ky seksion ka të bëjë vetëm me trajtimin e ofertave të MB në rast se OST deklaron një gjendje emergjente. Proceset e zakonshme të Rregullave të Tregut do të suspendohen për kohëzgjatjen e Gjendjes Emergjente në Sistem. Kur pjesëmarrësve u shkaktohen kosto shtesë duke mbështetur OST në veprimet e tij ndaj një Gjendje Emergjente në Sistem, atëherë ata mund të realizojnë këto sipas procedurave të përcaktuara në këtë seksion.

Duhet pasur parasysh se disa kosto, sikur Startimi nga Zero, mund të mbulohen nga një MShN. Çfarëdo pretendimi për këto kosto duhet të përjashtohet.

26. Procedura për Ndryshimin e Rregullave të Tregut

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike (2010) është detyrë e OT që të nxjerrë Rregullat e Tregut të përshtatshme për të përmbushur objektivat e Ligjit për Energjinë Elektrike, që do të thotë se rregullat duhet të evoluojnë me ndryshimin e kushteve në sistemin elektroenergetik të Kosovës.

Për të ofruar një nivel të mbikëqyrjes së pavarur të Procedurës së Ndryshimit do të themelohet një Panel Shqyrtues i Palëve të Interesit. Çdo Palë e cila ka aderuar në Rregullat e Tregut, gjithashtu dhe ZRRë, mund të ngritin një çështje lidhur me rregullat te Paneli. Nëse çështja kërkon një shqyrtim të mëtejme, OT do të hartojë (mundësisht së bashku me Palën) një Ndryshim të rregullave për të adresuar çështjen. Nëse OT nuk vepron me kohë, Pala mund të thirret në procedurën e Rregullave të Tregut për zgjedhjen e kontesteve ose formalisht do të dorëzojë një propozim- Ndryshim të vetin.


OT do të konsultohet me të gjitha Palët për draft Ndryshimin dhe do ta dorëzojë Raportin e Ndryshimit te Paneli Shqyrtues i cili do të vlerësojë nëse procedura është zbatuar me saktësi dhe nëse nevojitet punë e mëtejme, pastaj i dorëzohet ZRRë për miratim formal.

Pas miratimit nga ZRRë të ndryshimit të propozuar të Rregullave të Tregut, OT do të publikojë Ndryshimin e Rregullave të Tregut në ueb faqe duke ofruar datën e hyrjes në fuqi të implementimit, dhe inkorporojë Rregullin (at) e ri(reja) në versionin e ardhshëm të Rregullave të Tregut.

Do të ketë një proces formal dhe plan kohor për të adresuar Ndryshimet e Rregullave.

Procesi detal teknik do të përcaktohet në Procedurat e Tregut të referuara nga Rregullat e Tregut psh. Procedura e Tregut për Transferin e Konsumatorëve e përshkruar në Seksionin 7. Kjo do të sigurojë që Rregullat e Tregut të vazhdojnë të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme.


Ky seksion do të mbulojë proceset me të cilat Procedurat e Tregut janë zhvilluar dhe miratuar. Pritet që këto procese do të jenë më pak të vështira se sa Propozimet për Ndryshime pasi që këto do të merren vetëm me detajet teknike.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 36 nga 41

27. Dispozitat e Përgjithshme

Ky seksion mbulon pika të ndryshme përfshirë:

- Procedurat e Tregut të OT,
- Aderimin në Rregullat e Tregut,
- Fillimin,
- Njoftimet dhe Komunikimet,
- Auditimin e operimit të Rregullave të Tregut,
- Valutën,
- Konfidencialitetin d.m.th. se cilat të dhëna të ofruara sipas Rregullave të Tregut mund të vihen në dispozicion të Pjesëmarrësve tjerë në Treg ose ZRrE, dhe cilat jo,
- Forcën Madhore,
- Detyrimet dhe Juridiksionin, etj.


	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 37 nga 41

Shtojcat

Shtojca A: tregu D-1 plani kohor (indikativ)


09:00	<p>OST/OT publikon parashikimin e kërkesës për energji dhe parashikimin e humbjeve në ST për 24 orë si dhe programin e kompensimit dhe KTD të interkonektorëve për secilën orë të D</p> <p>Kur ka kapacitet të mjaftueshëm gjenerues OST publikon marginën e saj të rezervës</p>
10:00	OSSH njofton OST për prodhimin e planifikuar të centraleve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes <5MW ⁶
10:00	Furnizuesit njoftojnë OST/OT për parashikimin e kërkesës për energji për 24 orë (FP ndaras për KK dhe konsumatorët tarifor) dhe nominojnë programin dhe kontratat e tyre të gjenerimit/importit për ti mbuluar ato.
10:00	Gjeneratorët (jo BRE) njoftojnë OST (kopje për Furnizuesit e kontraktuar) për kapacitetin në dispozicion të njërive të tyre në secilën orë të D, dhe nominojnë prodhimin e tyre që i dedikohet Palës kontraktuese.
10:00	BRE nominojnë te OST parashikimin e tyre të prodhimit në secilën orë të D.
11:00	Tregtarët importues/eksportues nominojnë tek OST rrjedhat e tyre interkonektive për secilën orë të D dhe palën kontraktuese. OST përsëri kontrollon regjistrin e DKI, përlogaritë çfarëdo kongjestioni të parashikuar të interkonektorit dhe nëse ka, njofton importuesit/eksportuesit për çfarëdo ndryshimi (zvogëlimi të kapacitetit). OST/OT gjithashtu publikon DKI gjatë ditës. Importuesit/eksportuesit mund të dorëzojnë nominimet e përmirësuara të interkonektorëve.
12:00	OST kontrollon a janë nominimet të harmonizuara dhe të balancuara dhe publikon parashikimin e saj për (jo) balancet dhe humbjet e sistemit për secilën orë të D, revidimin e DKI gjatë ditës, dhe njofton Gjeneratorët për orarin e tyre indikativ të prodhimit. OST gjithashtu mund të tërheq vërejtjen Furnizuesve për ndonjë situatë të mungesës së furnizimit të parashikuar në D dhe i fton ata që të konkludojnë kontrata për importe afatshkurta dhe/ose përdor mjetet tjera për të mënjanuar jo-balancin.
12:00 deri 15:00	Furnizuesit mund të dorëzojnë sërish nominimet e përmirësuara të kërkesës për energji dhe palën kontraktuese,

⁶ 5MW është niveli i pragut i përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike (2010) për vendosjen e obligimeve ndaj prodhuesve të energjisë.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 38 nga 41


	Gjeneratorët disponueshmërinë e përmirësuar të njësive gjeneruese. Importuesit nominimet e përmirësuara për rrjedhat interkonektive.
15:00	Të gjithë Gjeneratorët dhe Furnizuesit dorëzojnë oferta për shitje dhe blerje (çmimin & sasinë) te Mekanizmi Balancues të OST. Këto tani mbyllen.
15:30 (Mbyllja e Portës)	OST finalizon programin e prodhimit, neto rrjedhat interkonektive dhe parashikimin e kërkesës për energji dhe humbjet në transmision.
15:45*	OST dorëzon programin e prodhimit, parashikimin e kërkesës për energji dhe programin e shkëmbimit te Koordinatori i Bllokut Rregullues/Qendra Koordinative.
17:15*	OST pranon konfirmimin e programit të prodhimit dhe programit të shkëmbimit, dhe njofton OT.
17:30	OT njofton importuesit/eksportuesit se nominimet e programeve të tyre tani janë të konfirmuara. OST konfirmon programin përfundimtar të prodhimit dhe publikon vlerësimin përfundimtar për humbjet.

*Këto afate kohore përcaktohen sipas planit kohor të ENTSO-E


	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 39 nga 41

Shtojca B: Definicionet

Termi	Definicionet
Çmimi i Jo-Balancit	Çmimi i përdorur për të përcaktuar detyrimin financiar për jo-balancin e energjisë.
Fondi për Energjinë e Ripërtërishme	Një fond, i administruar nga OT, i themeluar në pajtim me Skemën Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme.
Instrukcioni	Një instruksion nga OST për një Palë Tregtare që të devijoj nga Pozita e saj e Nominuar (si është ndryshuar në ndonjë Instruksion paraprak).
Jo-Balanci i Energjisë	Rrjedhat e energjisë të atribuara një Pale Tregtare të cilat nuk janë objekt i një kontrate bilaterale.
Llogaria e Energjisë e Devijimeve të Paqëllimshme	Sistemi i përdorur nga OT për të regjistruar balancin e përgjithshëm të sistemit.
Llogaria e MB	Sistemi i përdorur nga OT që të regjistroj rrjedhat e parasë lidhur me Mekanizmin Balancues; përfshirë rrjedhat e parasë të ndërlidhura me barazimin e Ofertave për blerje/shitje të pranuar të MB dhe Jo-Balancëve të Energjisë.
Mekanizmi Balancues	Mekanizëm primar (themelor) i përdorur për të arritur balancin e sistemit. MB i ofron OST energji elektrike që në mënyrë aktive të balancoj sistemin dhe Palët Tregtare me energji elektrike për të mbuluar çfarëdo devijime të paqëllimshme nga Pozitat e Instruktura të tyre.
Njësia Gjeneruese	Një definicion ekzistues në Kodin e Rrjetit: “Grup pajisjesh që prodhojnë energji elektrike.”
Nominoj, Nominimi	Procesi i përdorur nga një Palë Tregtare për të deklaruar rrjedhat e tyre të pritura të energjisë në ose nga sistemi transmetues.
Oferta për shitje (offer)	Një ofertë nga një Palë Tregtare për të shitur energji sistemit nëpërmjet Mekanizmit Balancues. Pranimi i një Oferte nga OST nëpërmjet lëshimit të një Instruksioni formon kontratë ndërmjet OST dhe Palës Tregtare.
Ofertë për blerje (Bid)	Një propozim nga një Palë Tregtare që të blejë energji nga sistemi nëpërmjet Mekanizmit Balancues. Pranimi i një oferte nga OST nëpërmjet lëshimit të një Instruksioni formon kontratë ndërmjet OST dhe Palës Tregtare.
Palët Tregtare	Një palë e Rregullave të Tregut e cila ka aderuar në një nga rolet si gjenerator, furnizues apo furnizues me shumicë dhe tregtarë ndërkufitar.
Pozita e Instruktuar	Neto pozita e Palës Tregtare e modifikuar si pasojë e instruksionit për ndryshimin nga Pozita e Nominuar.
Pozita e Nominuar	Programi i Rrjedhave të pritura të energjisë së një Pale Tregtare në ose nga sistemi transmetues.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 40 nga 41

Programi i Kompensimit	Një program i importeve dhe eksporteve i dorëzuar nga Koordinator i Bllokut/Qendra Koordinative i përshkruar në Doracakun Operativ të ENTSO-E. Programi ka për qëllim kompensimin e devijimeve të paqëllimshme duke eksportuar ose importuar nga sistemi interkonektiv gjatë periudhës së kompensimit nëpërmjet programeve të energjisë konstante brenda periudhave të njëjta tarifore kur ato kanë ndodhur.
rritës	Instruksion nga OST për të rritur prodhimin ose zvogëluar konsumin.
Skema Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme	Një skemë për të mbështetur BRE e përcaktuar në dokumentin e ZRrE “Rregullat për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranimin në Skemën Mbështetëse”.
Stabilimente për Prodhimin e Energjisë elektrike	Grup i pajisjeve për prodhimin e energjisë elektrike së bashku me rrjetin e brendshëm të Gjeneratorit të kyçura në një pikë të vetme ose shumë pika në Rrjetin e Transmisionit ose Shpërndarjes.
zbritës	Instruksion nga OST që të ulë prodhimin ose rritë konsumin.

	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës DTEEK	DT-KSHE-005
	ver. 1.0	faqe 41 nga 41

Shtojca C: Shkurtesat

BRE	Burimet e Ripërtritshme të Energjisë
D	Dita e Tregtimit
DKI	E Drejta e Kapacitetit Interkonktiv
DOS	Detyrimet e Operatorit të Sistemit
DOT	Detyrimet e Operatorit të Tregut
DRr	Detyrimet për Rrjetin e Transmisionit
DTEEK	Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë
EJL	Evropa Jug Lindore
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (<i>ang. European Network of Transmission System Operators for Electricity</i>)
FHSh	Faktori i Humbjeve të Shpërndarjes
FP	Furnizuesi Publik i energjisë elektrike
GPT	Grupi Punues Teknik
KDI	Kapaciteti i Disponueshëm i Transferit
KK	Konsumatori i Kualifikuar
KKT	Konsumatori i Kualifikuar i Transferuar
KM	Kodi i Matjes
KMSH	Kodi i Matjes së Shpërndarjes
MB	Mekanizmi Balancues
MBE	Marrëveshja për blerjen e energjisë
MNOST	Mekanizmi Nxitës për Operatorin e Sistemit të Transmisionit
MShN	Marrëveshja për Shërbime Ndhimëse
OFP	Obligimi i Furnizimit Publik
OS	Operatori i Sistemit
OT	Operatori Tregut
RrT	Rregullat e Tregut
PP	Prodhues i Pavarur
SMER	Skema Mbështetëse për Energji të Ripërtërishme
SSh	Sistemi i Shpërndarjes
ST	Sistemi i Transmisionit

(Fundi i Dokumentit)